

Tiranë, më 02.12.2016

K Ë R K E S Ë

K Ë R K U E S:

1.SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008, me seli qëndrore në Tiranë, me adresë: Bulevardi “Zogu I”, “Veve Busnes Centre”.

2.UNIONI GJYQTARËVE TË SHQIPËRISË, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2171, datë 04.02.2008, me seli qëndrore në Tiranë, me adresë: Rruga “Nikolla Tupe”, pallati 4, kati 2.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

O B J E K T I:

1. Deklarimin dhe shfuqizimin e neneve 8, 23 pika 10, 26 pika 4 gërma “b”, 28 gërma “c”, 53 pika 3 dhe 10, 104 pika “ç”, 105 pika 1 gërma “d”, 110, 112 pika 1, 117, 119 pika 2 gërma “a”, 141 pika 1, 147 pika 2, 150, 152, 160, 161 pika 3, 162 pika 2 gërma “b”, 164 pika 2, 165, 166 pika 1 dhe 2 gërma “b”, 169 pika 3, 5 dhe 6, dhe neni 173 pika 1, të

Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si të papajtueshëm me Kushtetutën.

2. Pezullimi i zbatimit të Ligjit Nr. 96/2016, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4, 5, 7, 15, 17, 18, 30, 33, 34, 42, 49, 138, 140, 147, 147/a dhe 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Ligjin Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËRPARA GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

I nderuar Z. Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj gjyqtarë kushtetues,

Po ju paraqesim më poshtë kërkesën tonë, duke parashtruar faktet dhe rrethanat, ligjin përkatës, ku jemi mbështetur, analizën dhe arsyetimin ligjor, për të arritur në konkluzionin se, kërkesa jonë duhet pranuar.

I. LEGJITIMITETI

1. Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (në vijim SHKGJRSH) dhe Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (në vijim UGJSH), në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “h” e Kushtetutës dhe neni 49, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, legjitimohen *ratione personae* t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, për arsye se si SHKGJRSH ashtu dhe UGJSH janë organizata në kuptimin që e përdor neni i sipërcituar i Kushtetutës, rregjistruar si persona juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përkatësisht me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008 (SHKGJRSH) dhe me vendimin Nr. 2171, datë 04.02.2008 (UGJSH). Në nenin 3 të Statutit të SHKGJRSH-së, nën titullin “**Qëllimi dhe veprimtaria**” thuhet shprehimisht: “*Shoqata ka*

këto qëllime dhe kryen këto veprimtari: Konsolidimin, forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe të sistemit gjyqësor në tërësi; - Promovimin dhe inspirimin e vlerave të gjyqtarëve, në veçanti, dhe të sistemit gjyqësor në përgjithësi në Republikën e Shqipërisë, zhvillimin e profesionalizmit në gjyqësor, rritjen e besueshmërisë së publikut tek gjyqësori dhe institucionet ndërkombëtare, zhvillimin dhe implementimin e statusit të gjyqtarëve në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me standardet ndërkombëtare në këtë fushë; - synon mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor.- Mbrojtjen e sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndërmarrë iniciativa për goditjen e ligjeve antikushtetuese, që kanë të bëjnë me këtë sistem apo statusin e gjyqtarëve, në Gjykatën Kushtetuese;..”

2. Në nenin 1 të Statutit të UGJSH parashikohet se: “*Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, shoqërore, intelektuale, materiale, si dhe në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare*”. Siç rezulton edhe nga vendimi për regjistrimin si person juridik, anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Ndërkohë në nenin 8 të Statutit të UGJSH, parashikohet se “*...duke bashkuar gjyqtarët, shoqata ka për qëllim të ndihmojë në mbrojtjen e interesave të tyre ...; të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv*”.

3. SHKGJRSH dhe UGJSH legjitimohen *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin e tyre për antikushtetutshmërinë e Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji Nr. 96/2016). Gjykata Kushtetuese ka theksuar edhe më parë se, në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, për gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve normative, subjektet që parashikohen në këtë dispozitë, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe pretendimit për shkelje kushtetuese në çështjen e ngritur. Shoqatat (organizatat e tjera) janë parashikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “h” të Kushtetutës, ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Për të vlerësuar legjitimitimin e subjektit, Gjykata përcakton fillimisht të drejtën kushtetuese të subjektit, që pretendohet se i është cenuar nga norma konkrete e kundërshtuar para saj. Subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës

legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike në qoftë se vetë norma ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës Kushtetuese. Në çështjen në shqyrtim, SHKGJRSJ dhe UGJSJ do të evidentojnë se ligji i kundërshtuar ka cenuar në përmbajtje, standardet kushtetuese që kanë të bëjnë me:

a) parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe, në veçanti,

b) parimin e shtetit të së drejtës,

c) parimin e sigurisë juridike,

d) parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve

e) me pavarësinë e pushtetit gjyqësor,

f) statusin e gjyqtarëve,

g) parimin e palëvizshmërisë,

h) të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor,

i) të drejtën për të mos u dënuar dy herë të për njëjtën fakt,

j) prezumimin e pafajësisë,

k) parimin e barazisë përpara ligjit

l) të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe të drejtën e karrierës, të drejtën për t'u promovuar dhe transferuar, etj...

m) parimin e proporcionaliteti

Ndodhur në këto kushte, SHKGJRSJ-ja dhe UGJSJ vlerësojnë se, ekziston lidhja e domosdoshme ndërmjet veprimtarisë së tyre dhe çështjes kushtetuese të ngritur prej tyre. Këto shoqata legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese lidhur me pretendimet e paraqitura para saj në objektin e kërkesës.

4. Gjithashtu, SHKGJRSJ-ja dhe UGJSJ legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është regjistruar brenda afatit të parashikuar në ligjin Nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji, objekt shqyrtimi, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 208, më datë 7 nëntor 2016. Vetë ligji, në nenin 175 të tij, përcakton se "Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare". Rezulton se ky afat 15 ditor është plotësuar në datën 22.11.2016. Në nenin 50 të ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se: "Kërkesat për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre".

5. Si shoqata, objekti dhe fokusi i së cilave është mbrojtja e interesave profesionale, shoqërore, intelektuale, material të gjyqtarëve, si dhe forcimi i një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare, SHKGJRSJ dhe vecanërisht UGJSH, që në krye të iniciativës së ndërmarrë prej Kuvendit të Shqipërisë për reformimin e sistemit të drejtësisë, kanë kontribuar aktivisht dhe në mënyrë permanente me pjesëmarrjen, opinionet dhe ekspertizën e tyre. Sikundër e kemi theksuar edhe më parë, pavarësisht rolit, misionit dhe kapacitetit të shoqatave tona, jemi të keqardhur nga qëndrimi i Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi, i cili në produktet e punës së tij, nuk reflektoi sugjerimet, opinionet, apo vërejtjet e parashtruara nga SHKGJRSJ UGJSH, një pjesë e konsiderueshme e të cilave gjetën pasqyrim vetëm pas opinionëve të Komisionit të Venecias dhe kjo vetëm përsa i përket amendamenteve Kushtetuese. Përsa i'u përket korpusit të ligjeve kryesore të sistemit të drejtësisë, duke filluar nga ligjinr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe ligjit *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, ligjit nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*...etj, UGJSH dhe SHKGJRSJ janë lënë jashtë marrjes së mendimit, duke u paragjykuar, apo duke mos dëshiruar të merren në konsideratë, pavarësisht se vërejtjet, apo sugjerimet tona kanë qënë konform standarteve të sanksionuara në Kushtetutë, apo aktet ndërkombëtare si KEDNJ, apo opinionet e Këshillit të Europës, Komisionit të Venecias, Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europiane...etj. Prandaj ndodhur në një situatë, kur sugjerimet, apo opinionet tona, jo vetëm që nuk u morën në konsideratë, por përkundrazi në disa prej dispozitave të Ligjeve të miratuara së fundmi, devijohet nga qëllimi sublim i tyre dhe çënohen në thelb standartet minimale të një shteti të së drejtës, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të garantuara prej Kushtetutës, apo KEDNJ, SHKGJRSJ dhe UGJSH kanë zgjedhur për herë të parë të bashkohen, për t'u përballur me këto Ligje në këtë Gjykatë të Nderuar, për të garantuar dhe mos lejuar çënimin e shtetit të së drejtës dhe të drejtave dhe lirive themelore.

II. ARSYETIMI JURIDIK

A. Lidhur me marrjen e masës së pezullimit të Ligjit Nr. 96/2016 që kundërshtohet si antikushtetues.

6. Me miratimin e ligjit Nr. 76/2016, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”*, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 138, datë 27 korrik 2016, Kushtetutës i janë bërë ndryshime në pjesën që

rregullon sistemin e drejtësisë në vend. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, nga ana e Ligjvënësit janë miratuar një sërë ligjesh, përfshi këtu dhe Ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

7. SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja, duke vlerësuar se nenet 8, 23 pika 10, 26 pika 4 gërma “b”, 28 gërma “c”, 53 pika 3 dhe 10, 104 pika “ç”, 105 pika 1 gërma “d”, 110, 112 pika 1, 117, 119 pika 2 gërma “a”, 141 pika 1, 147 pika 2, 150, 152, 160, 161 pika 3, 162 pika 2 gërma “b”, 164 pika 2, 165, 166 pika 1 dhe 2 gërma “b”, 169 pika 3, 5 dhe 6, dhe neni 173 pika 1, të Ligjit Nr. 96/2016 bien në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e RSH dhe Konventën Europiane të së Drejtave të Njeriut (më poshtë KEDNJ), bazuar në nenin 45 të Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nën titullin “**Pezullimi i ligjit ose aktit**”, ku parashikohet shprehimisht: “1. Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, **kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve** sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. 2. Vendimi për masën e pezullimit i njoftohet organit përkatës që ka nxjerrë ligjin ose aktin, si dhe bëhet publikimi i tij. 3. Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, me vendim në seancën plenare, mund të heqë masën e pezullimit. 4. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit. 5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në çdo rast jepet i arsyetuar dhe publikohet menjëherë.”, i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese **pezullimin e zbatimit të Ligjit Nr. 96/2016** për arsyet si më poshtë vijon:

7.1. **Së pari**, neni 160 pika 1 dhe neni 173 pika 1 të Ligjit Nr. 96/2016 sjellin pasoja që prekin interesat shtetërorë, pasi nga zbatimi i këtyre dispozitave krijohet vakum institucional, deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të organit shtetëror, sikurse është Këshillimi i Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD), si organi i vetëm kushtetues i vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor. Nëpërmjet këtyre dispozitave, në kundërshtim flagrant me nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (më poshtë KLGJ), KLD-së i janë hequr kompetencat për të bërë: **a)** emërimet e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit; **b)** transferimet e gjyqtarëve; **c)** emërimet dhe shkarkimet e kryetarëve të gjykatave apo **d)** komandimet e tyre dhe **e)** emërimi i inspektorëve të Inspektoriatit të KLD-së. Kështu, në nenin 173 pika 1 të Ligjit Nr.96/2016 nën titullin “**Shfuqizime**” thuhet shprehimisht: “1. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe

*funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të neneve si më poshtë: a) neni 2, shkronjat “b”, “ç”, “d”, “dh”; b) nenet 3, 4, 5, neni 6, pika 3, neni 7, pika 1, neni 8, pikat 1 dhe 2, nenet 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”. Ndërkohë në nenin 2 të Ligjit Nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar, nën titullin “Detyrat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” parashikohet shprehimisht se: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë ushtron këto detyra: a) **I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.** b) **Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.** c) **Vendos për transferimin e gjyqtarëve.** ç) **Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve.** d) **Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve.** dh) **Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre.** e) **Emëron dhe shkarkon, kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.** ë) **Emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.** f) **Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.”.** Nga përmbajtja e neneve 160 pika 1 dhe 173 pika 1 i Ligjit Nr. 96/2016, duke e ballafaquar me nenin 2 të Ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” rezulton se, që prej datës 22.11.2016 me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.96/2016, KLD-së i është hequr kompetenca kushtetuese dhe ligjore për të bërë emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, transferimin e gjyqtarëve, emërimin dhe shkarkimin e kryetarëve të gjykatave (pra, as shkarkimi i kryetarëve të gjykatave kur kryejnë shkelle të ligjit, në cilësinë e kryetarit nuk mund të bëhet më deri në krijimin e KLGJ!!) dhe emërimin e inspektorëve të Inspektoriatit të KLD-së. Ndërkohë që, KLD-së i është lënë kompetenca për të bërë vetëm procedimin disiplinor dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe inspektorëve, si dhe emërimin e gjyqtarëve të rinj që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016.*

Bazuar në formulimin e mësipërm të këtyre dispozitave pyetjet që të lindin natyrshëm janë;

- **Nëse sot KLD-ja është e pabesueshme për Ligjvënësin, përse KLD-së i është lënë kompetenca për të bërë procedimet disiplinore përfshi edhe shkarkimet e gjyqtarëve ndërsa, për emërimet, transferimet dhe komandimet e tyre dhe të kryetarëve të tyre jo?**

- *Duhet të ketë më shumë besueshmëri KLD-ja kur bën emërimet sesa kur bën shkarkimet e gjyqtarëve?*
- *Cilët janë këto kritere që i japin më shumë rëndësi emërimeve, transferimeve, promovimeve dhe komandimeve të gjyqtarëve apo dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave nga procedimi disiplinor (përfshi edhe shkarkimin) e gjyqtarëve?*
- *Cili është motivi i vërtetë i Ligjvënësit në përgjysmimin e kompetencave të KLD-së në kundërshtim flagrant me Kushtetutën?*

SHKGJRSJ dhe UGJSJ nuk dëshirojnë, madje refuzojnë ta besojnë se, përgjigjet për këto pyetje janë: **a)** krijimi i një kaosi në pushtetin gjyqësor, duke shkelur në mënyrë të hapur parimin kushtetues të vazhdimësisë institucionale; **b)** cënimi i së drejtës së gjyqtarëve për t'u emëruar dhe transferuar në përputhje me ligjin e Kushtetutën; apo ajo që është me e rënda: **c)** bllokimin tërësor të veprimtarisë së gjykatave në vend (*sepse, sikundër do ta shpjegojmë më poshtë, nuk mund të ketë më short në gjykatë, nuk mund të ketë paga për gjyqtarët, pasi nënshkruhen nga kryetari urdhrat e shpenzimeve, etj...*) nga lënia e gjykatave pa kryetar gjykatash në rastet kur, ata japin dorëheqjen, shkarkohen si gjyqtar, bëhen fizikisht apo mendërisht të paafte, ndërrojnë jetë, etj....

7.2. Kështu, në nenin 18 Ligjit Nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nën titullin “**Kompetencat e kryetarit të gjykatës**”, thuhet shprehimisht: “1. Një herë në çdo dy vjet kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit përcaktojnë shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma dhe seksione për vitet në vijim. Kjo ndarje nuk e pengon kryetarin e gjykatës që, gjatë vitit kalendarik, për nevoja pune, të komandojë gjyqtarë për të gjykuar në një seksion tjetër. 2. Kryetari i gjykatës ku ndodhet qendra e veprimtarisë së rrethit gjyqësor, që ka në kompetencë tokësore dy ose më shumë qendra të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, cakton me short gjyqtarët që do të gjykojnë në to, sipas një grafiku të veçantë, në varësi të numrit dhe karakterit të çështjeve. 3. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit, përveç sa më sipër, kryejnë edhe këto detyra: a) përfaqësojnë gjykatën në marrëdhëniet me të tretët; b) bëjnë ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjyqësorë; c) në fillim të çdo muaji, bëjnë planifikimin e gjyqtarëve për gjykimet me objekt vlerësim i arrestit në flagrancë apo ndalimit, caktimin e masave të sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër gjatë fazës së hetimit, sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin; ç) organizojnë diskutime për çështje të natyrës juridike, bazuar në përgjithësimin e përvojës së gjykimit, vendimet unifikuese të Gjykatës së

Lartë, vendimet e gjykatave të tjera, vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, aktet e kontrollit dhe inspektimit të ushtruara nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë; d) mbikëqyrin respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe planifikimin e çështjeve gjyqësore për qëllime të vlerësimit profesional; dh) marrin kontakt me ekipet e kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë apo të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, njihen me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijojnë atyre mundësi në ushtrimin e detyrës; e) mbikëqyrin disiplinën në punë të gjyqtarëve; ë) bashkërendojnë punën me Shkollën e Magjistraturës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për çështje të ngritjes profesionale të gjyqtarëve; f) kujdesen për çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë; g) kryejnë detyra të tjera në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës, të parashikuara në aktet ligjore ose nënligjore në fuqi. 4. Në mungesë të kryetarit, detyrat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni kryhen nga një gjyqtar i autorizuar prej tij.”.¹

5.7. Por, nëse zbatohet Ligji Nr. 96/2016 atëherë, rrezikohet të krijohet vakum institucional duke u paralizuar puna e gjykatave, për shkak se KLD-ja nuk mund të veprojë me shpejtësi për komandimin e kryetarëve të gjykatave dhe emërimin e tyre në përputhje me ligjin, në kushtet kur i janë hequr kompetencat në periudhën tranzitore deri në krijim e KLGJ-së. E njëjta situatë ndodh edhe kur një kryetar gjykate abuzon me detyrën si kryetar. Për shkak se, tashmë KLD-ja nuk ka më kompetencë ta shkarkojë këtë kryetar që ka shkelur ligjin, Gjykata në fjalë do të vijojë të drejtohet nga një kryetar, që abuzon me detyrën e tij si kryetar (jo si gjyqtar, pasi kryetari i gjykatës mund të shkarkohet edhe për motive të ndryshme nga ato të gjyqtarit). Në ligjin aktual nuk parashikohet pozicioni i **“zëvendëskryetarit”**, pasi këtë detyrë e kryen një person i autorizuar posacërisht nga kryetari rast pas rasti në mungesë të tij. Prandaj, nëse kryetari nuk autorizon një gjyqtar për të qenë

¹Në nenin 92 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” nën titullin “Shfuqizime” parashikohet se: “1. Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të: a) nenit 18, pikat 1 dhe 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat shfuqizohen katër muaj pas ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor; b) nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e cila shfuqizohet 18 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; c) nenit 18, pika 4, i ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e cila shfuqizohet me zgjedhjen e zëvendëskryetarit; ç) neneve 26 dhe 27, për pagat e gjyqtarëve, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të cilat shfuqizohen pasi të jetë vënë në zbatim sistemi i ri i pagave dhe përfitimeve, sipas parashikimeve të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

zëvendëskryetar dhe Gjykata mbetet pa kryetar, në largimin e kryetarit, Gjykata nuk mund të drejtohet nga askush dhe bën që ajo të mos funksionojë.

5.8. SHKGJRSH-ja dhe UGJSH shtrojnë pyetjen: A e lejon Kushtetuta vakumin institucional dhe a ia heq kompetencat KLD-së me hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese?

Përgjigjia është- **JO!** Kjo parashikohet shprehimisht në nenin 179, pika 5 dhe 12 të Kushtetutës, të ndryshuar, ku thuhet se : “5. *Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe dy anëtarë jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandate trevjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Për emërimet e para për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve sipas nenit 147, të Kushtetutës, do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.....12. Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, anëtarët e KLD-së përfshi këtu dhe Presidentin e Republikës si kryetar i këtij Këshilli, vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat kushtetuese të KLD-së, në respektim të parimit kushtetuese të vazhdimësisë institucionale, deri në zgjedhjen e gjithë anëtarëve të KLDGJ-së, pavarësisht faktit nëse do të krijohet apo jo brenda 8 muajve ky i fundit, sikurse ka vendosur Kushtetuta si afat maksimal. Gjithashtu, në këtë dispozitë kushtetuese nuk vendosen kufizime përse i përket kompetencave që duhet të ushtrojë KLD-ja. Formulimi i kësaj dispozite kushtetuese paraqitet si një dispozitë përjashtimore e kufizuese dhe si e tillë, duhet interpretuar në mënyrë strikte e të zbatohet drejtpërdrejtë, pasi në këtë dispozitë nuk është parashikuar mundësia e rregullimit të marrëdhënies përkatëse me anë të ligjit. Pra, kjo dispozitë e Kushtetutës nuk përmban elementet e një norme referuese, për shkak se nuk i është deleguar e drejta ligjvënës për të përcaktuar kompetencat që do të ketë KLD-ja deri në krijimin e KLDGJ-së.*

5.9. Ndodhur në këto kushte, vlerësojmë se Ligji Nr. 96/2016 në dispozitën që ka kufizuar kompetencat e KLD-së, ka cënuar: a) parimin e shtetit të së drejtës, b) parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe c) statusin e gjyqtarëve, konkretisht të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin (neni 49 i Kushtetutës) dhe të drejtën e karrierës, që përfshinë të

drejtën e tyre për t'u promovuar (emërim në gjykatë apeli), emërimin si kryetar gjykate dhe të drejtën për t'u transferuar në përputhje me ligjin. Gjithashtu, kjo dispozitë ka krijuar një vakum inistucional me pasoja të rënda shtetërore, që lidhen me mirëadministrimin e pushtetit gjyqësor si kompetencë funksionale e KLD-së.

6. Gjithashtu, për të konkluduar nëse krijimi i vakumit institucional deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të organit shtetëror, sikurse është KLD-ja, që vjen si rezultat i një Ligji antikueshtetues, është shkak i mjaftueshëm për pezullimin e ligjit, mbajmë parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin e saj Nr. 9, datë 23.03.2010 ndër të tjera ka theksuar se: ***“B. Lidhur me kërkesën për pezullimin e ligjit për pastërtinë e figurës 14. Kërkuesit, krahas pretendimeve për papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave të ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, kanë parashtruar dhe argumenta ligjorë lidhur me pasojat që mund të sjellë për interesat shtetërore, shoqërore ose të individëve zbatimi i menjëhershëm i ligjit, para marrjes së vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese. 15. Sipas kërkuesve, nga zbatimi i menjëhershëm i ligjit interesave të rëndësishme shtetërore u shkaktohet një dëm shumë serioz dhe vështirësisht i riparueshëm; krijohen dukshëm mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet organeve kushtetuese dhe një autoriteti të krijuar me ligj të zakonshëm; cenohet apo kufizohet ushtrimi i veprimtarisë kushtetuese të Presidentit të Republikës, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm si dhe i të gjithë institucioneve të tjera të administratës publike, nga veprimtaria e Autoritetit të Kontrollit të Figurave; krijohet vakum institucional deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të organit shtetëror; përfundojnë marrëdhëniet e punës për funksionarët e lartë të shtetit, të cilët kanë status kushtetues. 16. Gjykata Kushtetuese, shkaqet e parashtruara nga kërkuesit lidhur me kërkesën për pezullimin e ligjit, në kuptim të nenit 45 të ligjit organik të saj, i ka vlerësuar si shkaqe të përlegjura për të argumentuar parandalimin e pasojave që mund t'i vijnë funksionimit normal të shtetit të së drejtës si dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve dhe mbi këtë arsytim vendosi pezullimin e ligjit deri në dhënien e vendimit të saj përfundimtar.”² Nga përmbajtja e këtij vendimi***

² Në vendimin Nr. 5, datë 2 Shkurt 2001 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: ***“Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë***

rezulton se, kufizimi i ushtrimit të veprimtarisë kushtetuese të KLD-së, duke krijuar vakum institucional deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të organit shtetëror, sikurse është KLD-ja, është **shkak i mjaftueshëm** për pezullimin e një ligji antikushtetues, si **e vetmja mundësi për të parandaluar pasojat**, që mund t'i vijë funksionimit normal të shtetit të së drejtës. Në rastin konkret, Ligjvënësi jo vetëm që ka vepruar në kundërshtim flagrant me Kushtetutën, por ka injoruar dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila është e detyrueshme për çdo organ shtetëror përfshi këtu dhe Kuvendin dhe **çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale**.

7. **Së dyti**, nenet 8, 23 pika 10, 26 pika 4 gërma “b”, 28 gërma “c”, 53 pika 3 dhe 10, 103, 104 pika “ç”, 105 pika 1 gërma “d”, 112 pika 1, 119 pika 2 gërma “a”, 141 pika 1, 147 pika 2, 150, 152, 160, 161 pika 3, 162 pika 2 gërma “b”, 164 pika 2, 165, 166 pika 1 dhe 2 gërma “b”, 169 pika 3, 5 dhe 6, dhe neni 173 pika 1, të Ligjit Nr. 96/2016 bien në kundërshtim të hapur me Kushtetutën pasi, sikurse do të trajtohet më poshtë, çënojnë **parimin e shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës), parimin e sigurisë juridike (nenet 4 dhe 42 të Kushtetutës), parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve (neni 7 i Kushtetutës), parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt (ne bis in idem) (neni 34 i Kushtetutës), parimin e prezumimit të pafajësisë (neni 30 i Kushtetutës), parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor (neni 145 i Kushtetutës), parimin e proporcionalitetit (neni 17 i Kushtetutës), parimin e barazisë përpara ligjit (neni 18 i Kushtetutës), të drejtën për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ), garantimin e të drejtës së mbrojtjes, të drejtat që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës që lidhen me statusin e gjyqtarit, si paprekshmëria a pagës dhe të drejtat e tjera, ku përfshihet dhe e drejta a karrierës, parimin e palëvizshmërisë nga detyra dhe e drejta për punë, sipas nenit 49/1 të Kushtetutës, ku përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme**. Ndodhur në këto kushte, vlerësojmë se cënimi i këtyre parime dhe të drejtave kushtetuese, përbëjnë shkaqe të përligjura për të argumentuar parandalimin e pasojave, që mund t'i vijë funksionimit normal të shtetit të së drejtës, si dhe të drejtave dhe lirive themelore të gjyqtarëve si funksionarë shtetëror dhe si individë. Prandaj, **kërkojmë pezullimin e Ligjit Nr. 96/2016 deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese!**

*fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. **Cdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale.***

8. Sa më sipër u arsyetua, SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja vlerësojnë se, plotësohen të gjitha kushtet e parashikuar nga neni 45 i Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për pezullimin e Ligjit Nr. 96/2016 deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

B. Lidhur me cënimin e parimit të shtetit të së drejtës.

9. Në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë deklarohet parimi i **shtetit të së drejtës**, i cili është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, **ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues**. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike.³

9.1. Në nenin 4, paragrafi i dytë i Kushtetutës deklarohet: “*Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë* “. Deklarimi i epërsisë së Kushtetutës, duke e vendosur në majë të piramidës së normave juridike, përbën një aspekt thelbësor të parimit të shtetit të së drejtës. Ky parim **detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese**. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike me të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material.⁴

10. Respektimi i **hierarkisë së akteve normative** është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. Për rrjedhojë, në rastet e

³Shiko vendimin Nr. 55, datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

⁴Shiko vendimin Nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, **norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër.**⁵

11. Neni 4/3 i Kushtetutës parashikon se, **dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti**, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. **Përfundimisht kushtetues i parashikuar në këtë dispozitë nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënkupton, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave. Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Edhe pse disa çështje që lidhen me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit.**⁶

12. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse ndodhemi përpara një norme ligjore, që nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por në tejkalime jashtëkushtetuese, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, atëherë do të cënohet **parimi i hierarkisë së normave**. Ky është një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese në disa çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar se **“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla ...”**.⁷

13. Në nenin 179 pika 5 dhe 12 të Kushtetutës, të ndryshuar, thuhet shprehimisht: **“5. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe dy anëtarë jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandate trevjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë**

⁵ Shiko vendimin Nr. 16, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese

⁶ Shiko vendimin Nr. 22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese

⁷ Shiko vendimin Nr. 29, datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

Gjyqësor, sipas ligjit. Për emërimet e para për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve sipas nenit 147, të Kushtetutës, do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.....12. Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, anëtarët e KLD-së përfshi këtu dhe Presidentin e Republikës si kryetar i KLD-së vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat kushtetuese të KLD-së, në respektim të parimit kushtetues të vazhdimësisë institucionale deri në zgjedhjen e gjithë anëtarëve të KLGJ-së, pavarësisht faktit nëse do të krijohet apo jo brenda 8 muajve ky i fundit, sikurse ka vendosur Kushtetuta si afat maksimal. Gjithashtu, në këtë dispozitë kushtetuese nuk vendosen kufizime përse i përket kompetencave që duhet të ushtrojë KLD-ja. Po ashtu, formulimi i kësaj dispozite kushtetuese paraqitet si një dispozitë përjashtimore e kufizuese, dhe si e tillë, duhet interpretuar në mënyrë strikte e të zbatohet drejtpërdrejtë pasi në këtë dispozitë nuk është parashikuar mundësia e rregullimit të marrëdhënies përkatëse me anë të ligjit. Pra, kjo dispozitë e Kushtetutës nuk përmban elementet e një norme referuese, për shkak se nuk i është deleguar e drejta ligjvënësit për të përcaktuar kompetencat që do të ketë KLD-ja deri në krijimin e KLGJ-së.

13.1. Në nenin 173 pika 1 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Shfuqizime”** thuhet shprehimisht: *“1. Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të neneve si më poshtë: a) neni 2, shkronjat “b”, “ç”, “d”, “dh”; b) nenet 3, 4, 5, neni 6, pika 3, neni 7, pika 1, neni 8, pikat 1 dhe 2, nenet 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”. Ndërkohë, në nenin 2 të Ligjit Nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar, nën titullin **“Detyrat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”** parashikohet shprehimisht se: *“Këshilli i Lartë i Drejtësisë ushtron këto detyra: a) I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve. ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve. dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre. e) Emëron dhe shkarkon, kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të**

shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. ë) Emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj. Nga përmbajtja e neneve 160 pika 1 dhe 173 pika 1 i Ligjit Nr. 96/2016, duke e ballafaquar me nenin 2 të Ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” rezulton se, që prej datës 22.11.2016 me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 96/2016, KLD-së i janë hequr kompetencat Kushtetuese dhe ligjore për të bërë emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, transferimi i gjyqtarëve, emërimi dhe shkarkimi i kryetarëve të gjykatave (*pra, as shkarkimi i kryetarëve të gjykatave kur kryejnë shkelje të ligjit si kryetar*) nuk mund të bëhet më deri në krijimin e KLGJ-së dhe emërimi i inspektorëve të të Inspektoriatit të KLD-së, ndërkohë që i është lënë kompetenca për të bërë shkarkimin e gjyqtarëve dhe inspektorëve. Pra, **sipas ligjvënësit anëtarët e KLD-së janë të përshtatshëm për të bërë shkarkime por, janë të papërshtatshëm për të bërë emërim dhe transferime të gjyqtarëve, si dhe emërimin e inspektorëve të KLD-së!?**

13.2. SHKGJRSJ-ja dhe UGJSJ-ja vlerëson se, **nenet 160 pika 1 dhe 173 pika 1 i Ligjit Nr. 96/2016 që, i kufizojnë kompetencat KLD-së në periudhën tranzitore bie në kundërshtim flagrant me nenin 179 pika 5 dhe 12 të Kushtetutës**, ku thuhet se anëtarët e KLD-së përfshi këtu dhe Presidentin e Republikës si kryetar i KLD-së vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat kushtetuese të KLD-së, në respektim të parimit kushtetues të vazhdimësisë institucionale, deri në zgjedhjen e gjithë anëtarëve të KLGJ-së, pavarësisht faktit nëse do të krijohet apo jo brenda 8 muajve ky i fundit, sikurse ka vendosur Kushtetuta si afat maksimal. Gjithashtu, në këtë dispozitë kushtetuese nuk vendosen kufizime përse i përket kompetencave që duhet të ushtrojë KLD-ja dhe nuk i delegohet ligjvënësit ndonjë kompetencë për rregullimin e periudhës tranzitore, ç’ka e bën këtë dispozitë kushtetuese drejtpërdrejtë të zbatueshme. Ndodhur në këto kushte, **legjislatori nëpërmjet neneve 160 pika 1 dhe 173 pika 1 të Ligjit Nr. 96/2016 ka cënuar respektimit e hierarkisë së normave juridike si element i parimit të shtetit të së drejtës**. Ky është një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese në disa çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar se **“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji.”**

14. Në nenin 140 të Kushtetutës të ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë

për kryerjen e një krimi. 3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit. 4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese rezulton se Kushtetuta, pa lënë shteg për mëdyshe, ka parashikuar në mënyrë shteruese si rastet e shkarkimit ashtu dhe rastet e pezullimit të gjyqtarit nga detyra, si garanci për ushtrimin normal të detyrës. Gjithashtu, Kushtetuta i ka diferencuar shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës që lidhen me shkeljet e rënda profesionale dhe etike gjatë ushtrimit të detyrës nga ato sjellje që në vetvete përbëjnë veprë penale, duke i parashikuar si shkaqe të ndryshme për largimin nga detyra. Kjo jo pa qëllim, **pasi nëse gjyqtari do të dënohej dy herë për të njëjtin fakt, sjellje, veprim ose mosveprim, si nga gjykata penale ashtu dhe nga KLGJ-ja, (për një nga shkeljet disiplinore të ndryshme nga shkarkimi, të cilin vetë kushtetuta e parashikon si një shkak të posaçëm të largimit nga detyra), atëherë do të shkelej parimi i dënimit dy herë për të njëjtin fakt (neni 34 i Kushtetutës)**, duke pasur parasysh dhe faktin që për procedimin disiplinor zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e procedimit penal. Po ashtu, për shkak të rëndësisë që ka ushtrimi i detyrës së gjyqtarit në një shtet të së drejtës dhe për të shmangur rastet e abuzimit të pezullimit të gjyqtarit nga detyra, kushtetutbërësi është kujdesur që të parashikojë në mënyrë eksplicite rastet e pezullimi të gjyqtarit nga detyra, të cilat janë kur: **a)** ndaj gjyqtarit caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”; **b)** ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; **c)** kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit. Nga interpretimi logjik i kësaj dispozite kushtetuese rasti i fundit bën fjalë për shkelje disiplinore aq të rënda, të cilat passjellin shkarkimin nga detyra të gjyqtarit. Në këtë përfundim arrihet duke pasur parasysh dy rastet e tjera që e lidhin me marrjen si të pandehur për një krim të rëndë me dashje (jo pakujdesi) dhe kur i kufizohet liria gjyqtarit me masë sigurimi personal, që sipas ligjit bëhet për krime. Pra, **intesiteti i shkeljes disiplinore, për të cilin ka filluar procedimi disiplinor duhet të jetë i tillë që të korrespondojë me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit, pasi nëse do lejohej e kundërta do të ishte në kundërshtim me qëllimin e kushtetutbërësit.**

14.1. Në nenin 104 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale**” parashikohet shprehimisht: “*Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë: a) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është*

deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë; b) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale nga pakujdesia; c) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat “a dhe “b”, të këtij neni, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë; ç) faktet e pranuar nga organi kompetent me vendim të formës së prerë, që për nga vetë natyra e tyre është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë, të cilat përbëjnë vepër penale, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, është rehabilituar apo ka përfitur nga falja dhe amnistia.”.

14.2. Gjithashtu, në nenin 151 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Pezullimi i detyruar**” parashikohet shprehimisht se: “1. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje. 2. Pezullimi, sipas pikës 1, të këtij neni, zgjat: a) gjatë periudhës së arrestit në burg ose arrestit në shtëpi, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “a”, të këtij neni; b) deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “b”, të këtij neni. 3. Kryetarët e gjykatave dhe të prokurorive, të cilët marrin vendimet përkatëse, detyrohen të njoftojnë Këshillin për faktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli, menjëherë pasi merr informacionet nga prokuroria ose gjykata, vendos pezullimin për shkak të ligjit të magjistratit.”, ndërsa në nenin 152 të këtij ligji nën titullin “**Pezullimi mbi bazë diskrecioni**” parashikohet shprehimisht se: “1. Nëse Këshilli krijon bindjen se qëndrimi në detyrë i magjistratit të akuzuar paragjykon hetimin penal ose disiplinor, pengon përfundimin në mënyrë të drejtë ose të rregullt të hetimit penal ose disiplinor apo diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, mund të pezullojë magjistratin nga detyra nëse: a) ndaj magjistratit ka nisur një hetim penal; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer nga pakujdesia; c) kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore. 2. Nëse Këshilli krijon bindjen, bazuar në provat e mjaftueshme, sipas parashikimeve të nenit 67, të këtij ligji, që magjistrati nuk mund të qëndrojë përkohësisht në

detyrë për shkaqe që lidhen me shëndetin fizik ose mendor, mund ta pezullojë nga detyra magjistratin. 3. Në rast se përfundon pezullimi i detyruar, Këshilli mund të vendosë pezullimin e magjistratit në përputhje me këtë ligj.”.

14.3. SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja vlerësojnë se, **neni 104 i Ligjit Nr. 96/2016 që parashikon si shkaqe të përgjegjesisë disiplinore deklarimin fajtor të një gjyqtari për një veprë penale kundravajtje të kryer nga pakujdesia apo me dashje, apo edhe nëse nuk është deklaruar fajtor për shkak se vepra penale është shuar, amnistuar, bie në kundërshtim flagrant me nenin 140 pika 2 gërma “b” të Kushtetutës.** Po ashtu, kjo dispozitë do të cënonte dhe parimin kushtetues se “*askush nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtin fakt*”, duke duke pasur parasysh dhe faktin që, për procedimin disiplinor zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e procedimit penal. Gjithashtu, konstatojmë se, **neni 152 i Ligjit Nr. 96/2016 që parashikon si shkaqe të pezullimit nga detyra mbi bazën e diskrecionit kur: “a) ndaj magjistratit ka nisur një hetim penal; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer nga pakujdesia; c) kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore”, bie në kundërshtim flagrant me 140 pika 3 të gërma “a” dhe “b” të Kushtetutës.** Sikurse e theksuam edhe më lartë, për shkak të rëndësisë që ka ushtrimi i detyrës së gjyqtarit në një shtet të së drejtës dhe për të shmangur rastet e abuzimit të pezullimit të gjyqtarit nga detyra, kushtetutbërësi është kujdesur që të parashikojë në mënyrë eksplicite rastet e pezullimi të gjyqtarit nga detyra, të cilat janë kur: a) *ndaj gjyqtarit catohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest bë shtëpi”*; b) *ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje*; c) *kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.*⁸ Nga interpretimi logjik i kësaj dispozite kushtetuese rasti i fundit bën fjalë për fillimin e **procedimit disiplinor** dhe **jo hetimin disiplinor** (janë nocione të ndryshme) për shkelje disiplinore aq të rënda, të cilat passjellin shkarkimin nga detyra të gjyqtarit. Në këtë përfundim arrihet duke pasur parasysh dy rastet e tjera që e lidhin me marrjen si të pandehuri për një krim të rëndë me dashje (jo pakujdesi) dhe kur i kufizohet liria gjyqtarit me masë sigurimi personal, që sipas ligjit bëhet për krimet. Pra, intesiteti i shkeljes disiplinore për të cilin ka filluar procedimi disiplinor duhet të jetë i tillë që të korrespondojë me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtari, pasi nëse do lejohej e kundërta do të ishte në

⁸ Nga ballafaqimi i nenit 140 pika 3 të Kushtetutës me nenin 152 të Ligjit Nr. 96/2016 konstatohet se ndonëse Kushtetuta për pezullimin e gjyqtarit thotë që “gjyqtari të jetë marrë i pandehuri për një krim të kryer **me dashje**”, Ligji thotë “mjafton të jetë marrë i pandehuri për një veprë penale **nga pakujdesia**”. Kushtetuta thotë të ketë filluar **procedimi disiplinor**, e cila është një fazë shumë më e avancuar se hetimi disiplinor sipas Ligjit, ndërkohë që, Ligji thotë që **mjafton dhe hetimi disiplinor**, pa u specifikuar se bëhet fjalë për shkelje disiplinore që passjellin shkarkimin e gjyqtarit apo, për çdo lloj shkelje.

kundërshtim me qëllimin e kushtetutbërësit. Ndodhur në këto kushte, **SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja vlerëson se edhe për nenin 152 ë Ligjit Nr. 96/2016 vlen parimi i elaboruar nga jurisprudence e Gjykatës Kushtetuese se “atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji”.**

15. Në nenin 143 të Kushtetutës, të ndryshuar parashikohet shprehimisht: “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit.*”. Në këtë dispozitë parashikohen papajtueshmëritë dhe kufizimet për shkak të funksionit për gjyqtarin. Në këtë dispozitë Kushtetuta është kujdesur për t’i parashikuar në mënyrë eksplicite papajtueshmëritë e gjyqtarit, të cilat janë: a) **ndalimi i gjyqtarit për të marrë pjesë në veprimtari politike**; b) **ndalimi i gjyqtarit për të kryer detyra të tjera shtetërore kundrejt pagesës**; c) **ndalimi i gjyqtarit për të kryer veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës**. Gjithashtu, vetë Kushtetuta për shkak të rëndësisë që ka funksioni i gjyqtarit në një shtet të së drejtës është kujdesur si për përcaktimin në mënyrë eksplicite të **shkaqeve që përbëjnë papajtueshmëri** me detyrën e gjyqtarit ashtu dhe për **rastet përjashtimore që nuk përbëjnë papajtueshmëri**, sikurse është ushtrimi i aktivitetit të mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit. Po ashtu, në këtë dispozitë Kushtetuta i ka deleguar ligjvënësit për të rregulluar me ligj procedurën e delegimit të gjyqtarit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë.

15.1. Në nenin 8 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Papajtueshmëria ambjentale**” parashikohet shprehimisht: “*1. Këshillat marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale që krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ ja, bashkëjetuesi/ja, ose persona të tjerë në lidhje të ngushtë nga gjaku ose me ligj, sipas parashi-kimeve të Kodit të Procedurës Civile. 2. Për këtë qëllim, në gjykatat dhe prokuroritë zbatohen parashikimet e mëposhtme: a) magistrati nuk ushtron funksionin në një gjykatë ose prokurori, nëse një magistrat tjetër, me të cilin ka lidhje të ngushta familjare, ushtron funksionin respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori; b) gjyqtari nuk ushtron funksionin në një gjykatë administrative të shkallës së parë nëse një gjyqtar tjetër, me të cilin ka lidhje të ngushta familjare, ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe anasjelltas; c) gjyqtari nuk ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë nëse një gjyqtar tjetër, me të cilin ka lidhje*

të ngushta familjare, ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën e zakonshme të shkallës së parë, si dhe anasjelltas; ç) magjistrati nuk ushtron funksionin në seksionin penal të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë dhe në prokurorinë në juridiksion të kësaj gjykate, nëse një magjistrat tjetër, me të cilin ka lidhje të ngushta familjare, ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksionin penal të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, si dhe anasjelltas. 2. Magjistrati nuk duhet të ushtrojë funksionin në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme nëse një magjistrat tjetër, me të cilin ka lidhje të ngushta familjare, ushtron funksionin në këto struktura. 3. Magjistrati duhet të njoftojë Këshillin pa vonesë në çdo rast papajtueshmërie ambientale para emërimit për herë të parë të tij. Magjistrati dhe kryetari njoftojnë Këshillin pa vonesë në rast se kjo papajtueshmëri lind gjatë ushtrimit të funksionit. 4. Në rast të evidentimit të rasteve të papajtueshmërisë ambientale, gjatë ushtrimit të funksionit në një gjykatë, magjistrati caktohet në një seksion tjetër. Në rast pamundësie, Këshilli respektiv transferon një nga magjistratët në gjykatën ose prokurorinë më të afërt të mundshme të të njëjtit nivel, në rast se magjistrati përmbush të gjitha kriteret e parashikuara për këtë pozicion. Këshilli transferon atë magjistrat, i cili: a) jep miratimin për transferimin; b) ka shkaktuar papajtueshmërinë ambientale, në rast se asnjë nga magjistratët përkatës nuk jep miratimin për transferim; c) ka më pak eksperiencë pune si magjistrat në gjykatë ose prokurori në krahasim me magjistratët tjetër, në rast se nuk arrihet një zgjidhje midis tyre. 5. Transferimi për shkak të papajtueshmërisë ambientale ka përparësi ndaj lëvizjeve paralele.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se legjislatori **ka shpikur një shkak papajtueshmërie, një kufizim** për ushtrimin lirisht e në bazë të ligjit të profesionit të gjyqtarit, të ndryshëm nga ato që ka parashikuar në mënyrë eksplicite Kushtetuta në nenin 143 të saj, të cilat janë: a) ndalimi i gjyqtarit për të marrë pjesë në veprimtari politike; b) ndalimi i gjyqtarit për të kryer detyra të tjera shtetërore kundrejt pagesës; c) ndalimi i gjyqtarit për të kryer veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës. Ndodhur në këto kushte, SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja vlerëson se edhe për nenin 8 të Ligjit Nr. 96/2016 vlen parimi i elaboruar nga jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese se **“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji”**. Prandaj, duhet të shpallet nga Gjykata Kushtetuese si në tejkalim të Kushtetutës.

15.2. SHKGJRSH dhe UGJSH çmojnë se, kufizimi i vënë në nenin 8 të Ligjit Nr.96/2016 cënon gjithashtu: 1) pavarësinë e brendshme të pushtetit gjyqësor, të parashikuar

nga neni 145/1 i Kushtetutës, pasi pushteti gjyqësor nuk ka hierarki dhe gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve; 2) parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës për shkak se ky shkak apo ndalim nuk është vendosur për shkaqe objektive dhe të përligjura; 3) parimin e proporcionalitetit në kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuar nga neni 17/1 i Kushtetutës për arsye se, vendos një kriter kufizues në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe pa pasur një interes publik të ligjshëm; 4) normat ndërkombëtare që rregullojnë statusin e gjyqtarit dhe të drejtën e tij për ngritje në detyrë pasi një kriter i tillë kufizues nuk është parashikuar në asnjë nga këto norma.

15.3. Në nenin 145/1 të Kushtetutës parashikohet se: *“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”*. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t’u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimin nr. 5, datë 16.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në nenin 145/1 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme (pavarësia nga pushtetet e tjera) ka dhe një pavarësi të brendshme (gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve).

15.4. Sipas nenit 8 **“Papajtueshmëria ambjentale”** të Ligjit Nr.96/2016, vendoset një kufizim shtesë në ushtrimin e profesionit të magjistratit (gjyqtarit) nga ato të përcaktuara qartësisht e në mënyrë shteruese nga neni 143 i Kushtetutës. Kriteri i mospasjes së konfliktit të interesit apo lidhjeve nepotike mes magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) të gjykatave të të gjithave niveleve dhe juridiksioneve, që vendos dispozita, objekt shqyrtimi, është një kriter shtesë, me një natyrë kufizuese dhe ndaluese, pasi ndalon magjistratin të emërohet për të ushtruar apo të vazhdojë të ushtrojë detyrën e tij në një gjykatë apo prokurori, në të cilën gjendet një i afërm i tij përkatësisht bashkëshorti/ ja, bashkëjetuesi/ja, ose persona të tjerë në lidhje të ngushtë nga gjaku ose me ligj, sipas parashi-kimeve të Kodit të Procedurës Civile. **Rrjedhimisht magjistratit (gjyqtarit në rastin konkret por edhe prokurorit) i cënohet e drejta për të zgjedhur lirisht profesionin apo për të bërë karrierë në profesion, çka vjen në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e RSH dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të RSH.**

15.5. SHKGJRSH dhe UGJSH sjellin në vëmendjen Tuaj jurisprudencën e kësaj Gjykate të nderuar në raste të ngjashme. Konkretisht në vendimin e saj Nr. 40/2014 Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: *“34. Siç ka vlerësuar më lart në paragrafin 22, se karriera është*

një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Dispozita konkrete, duke e lidhur zgjedhjen si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, edhe me vlerësimin e kriterit shtesë që ajo ka përcaktuar, vendos një kufizim të karrierës për gjyqtarët, të cilët gjenden në situatat ndaluese të parashikuara nga kjo dispozitë. Në vijim, Gjykata vlerëson nëse ky kufizim i karrierës është vendosur nga ligjvënësi në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta, pra për një interes publik dhe në proporcion me qëllimin që kërkohet të arrihet.... 36. E drejta/garancia e kufizuar nga ndërhyrja e ligjvënësit në rastin konkret është karriera e cila, si pjesë integrale e statusit të gjyqtarit, mbrohet nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha garancitë kushtetuese që përfshin ky nen si palëvizshmëria, mbrojtja e pagës si dhe “përfitimet e tjera” janë në funksion të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i tyre krijon njëkohësisht besimin te publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve. Gjykata, pasi ka vlerësuar të drejtën e kufizuar në raport me interesin publik, arrin në konkluzionin se kufizimi i karrierës nëpërmjet kriterit ndalues të parashikuar nga dispozita, objekt shqyrtimi, nuk është proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet nga ligjvënësi. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, KM, nuk parashtrroi argumente bindëse për të mbështetur qëndrimin se ky kufizim është i domosdoshëm dhe se qëllimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera më pak kufizuese. Për pasojë, pretendimi i kërkuesit se shprehja “...të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm” të shkronjës b/ii, të pikës 2 të nenit 3 të ligjit 8588/2000, të ndryshuar, cenon nenin 138 të Kushtetutës, në vlerësimin e Gjykatës, është i bazuar.”. Ndodhur në këto kushte, SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja vlerëson se edhe njëherë se, për nenin 8 të Ligjit Nr. 96/2016 vlen parimi i elaboruar nga jurisprudence e Gjykatës Kushtetuese se **“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji”**. **Prandaj, duhet të shpallet nga Gjykata Kushtetuese si në tejkallim të Kushtetutës si dhe në kundërshtim me nenet 17, 18, 49, 138 e 145 të Kushtetutës.**

16. Në nenin 138 të Kushtetutës, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.”. Ky përcakton elementë përbërës të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u

njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre.

16.1. Në nenin 26 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Ulja e ngarkesës**” parashikohet shprehimisht se: “1. Magjistrati ka të drejtë për ulje të ngarkesës së çështjeve, në rast nevoje, për një nga këto shkaqe: a) sëmundje e përkohshme, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet; b) studime jashtë kursit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në tre vjet. 2. Ngarkesa e çështjeve mund të ulet deri në 75 për qind të ngarkesës, në varësi të rrethanave. 3. Këshillat mund të vendosin ulje të ngarkesës së çështjeve të magjistratit, pas marrjes së mendimit të kryetarit, nëse plotësohen këto kushte: a) në rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, sëmundja e magjistratit kërkon ulje të ngarkesës në punë, bazuar në raportin e komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë në punë; b) në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni: i) kur studimet kanë si qëllim të rrisin aftësitë profesionale të magjistratit; ii) kur ulja e ngarkesës nuk cenon interesat thelbësorë të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse. 4. **Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: a) procedurën që ndiqet për kërkesat për uljen e ngarkesës, veçanërisht detajimi për provat e duhura që duhet të paraqiten në mbështetje të një kërkesë; b) në rastet kur kërkesa pranohet, rregullat për uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera, të bazuara në arsyet e shkronjës “a”, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, duke pasur në konsideratë nevojën për uljen e ngarkesës, të shkaktuar nga një rrethanë jashtë vullnetit të magjistratit;..**”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite konkretisht të pikës 4 gërma “b” rezulton së KLGJ-ja mund të miratojë rregulla të detajuara për uljen e pagës së gjyqtarit, në rastet kur për arsye shëndetësore gjyqtarit i maratohet kërkesa për uljen e ngarkesës në punë. Pra, në rastet kur gjyqtari paraqitet në punë por, nuk ka ngarkesë të plotë. Vlerësojmë se ky parashikim, në kushtet kur gjyqtari paraqitet në punë për të dhënë shërbimit të drejtësisë bie në kundërshtim me nenin 138 të Kushtetutës, ku parashikohen në mënyrë eksplicite rastet e uljes së pagës, të

cilat janë vetëm tre: **a) situatë e rëndë financiare e vendit apo emergjencave kombëtare;** **b) rikthimi në detyrën e mëparshme dhe c) marrja e masave disiplinore apo pamjaftueshmëria profesionale.** Në rastin konkret nuk jemi përpara këtyre rasteve, për rrjedhojë është shkëlur parimi i elaboruar nga jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese se **“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji”**.

16.2. Gjithashtu, vlerësojmë se kjo përbën një masë joproportionale si kufizim i të drejtës së pagës dhe si rrjedhojë vjen në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Paga e magjistratit nuk mund të ulet për shkak të uljes së ngarkesës në punë si pasojë e sëmundjes së tij. Sëmundja është një fakt natyror që nuk varet nga vullneti i magjistratit dhe nuk mund t'i mvishet pasojë në dëm të tij. I vetmi rast kur ligji parashikon një ulje të të ardhurave për një punëmarrës, duke përfshirë edhe funksionarin publik është kur ky i fundit ndodhet me raport mjekësor dhe është përkohësisht i paafte për të ofruar shërbimin e tij, duke u paguar nga punëdhënësi për një periudhë deri në 14 ditë dhe nga sigurimet shoqërore për periudhën nga dita e pesëmbëdhjetë deri në 6 muaj.

17. Në nenin 136 pika 3 të Kushtetutës, të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: ***“3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.*** **4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.**”, ndërsa në nenin 147 pika 2 të Kushtetutës parashikohet se: ***“2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë. 3. Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret të tjera dhe***

procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kriteret që mos të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, për t’u zgjedhur gjyqtar në Gjykatë të Lartë apo dhe anëtarë i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet t’i përmbushin vetëm kandidatët që nuk vijnë nga rradhët e gjyqtarëve apo që nuk kanë mbajtur statusin e gjyqtarit dhe ish gjyqtarit. Kjo është arsyeja pse në nenin 136/a të Kushtetutës parashikohet se: “1. *Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.* 2. *Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.*”.

17.1. Në mënyrë të detajuara kriteret për t’u emëruar gjyqtar janë parashikuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Kriteret e pranimit në formimin fillestar**” ku thuhet se: “Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; c) ka përfunduar, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, si dhe ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Europian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj; ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; e) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.”. Pra, në respektim të Kushtetutës sot që të kandidosh për t’u bërë gjyqtar i shkallës së parë, nuk parashikohet si kriter që të mos kesh mbajtur poste politike në administratën publike. Po ashtu, ky ligj në nenin 53 nën titullin “**Parimet e komandimit të magistratëve**” parashikohet se: “2. *“Institucioni në të cilin magistrati koman-dohet”, për pozicionin e ndihmësmagjistratit është....., Ministria e Drejtësisë.....Ushtrimi i funksioneve drejtuese në institucionin në të cilin magistrati komandohet vlerësohet si përvojë drejtuese”,* që do të thotë që magistrati

mund të komandohet në çdo pozicion përfshi këtu pozicionin e këshilltarit të ministrit të Drejtësisë dhe drejtorit të kabinetit të ministrit dhe kjo konsiderohet përvojë profesionale si drejtues. Pra, nuk përjashtohet mundësia që magjistrati të komandohet në pozicione pune që konsiderohen si pozicione politike në administratën publike.

17.2. Në nenin 166 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Dispozitat kalimtare për ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë**” parashikohet shprehimisht se: “1. Kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e rivlerësimit personat, **të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tre vjet, ose personat që kanë ushtruar funksionin e magjistratit për 9 vjet, në 20 vitet e fundit**, duke përfshirë gjyqtarët në një Gjykatë Ndërkombëtare, Gjykatë të Lartë, Gjykatë Kushtetuese. 2. Kriteret që duhet të përmbushin subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni janë: a) të mos jenë shkarkuar për shkelje disiplinore ose kryerjen e veprës penale; **b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji**; c) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga sigurimi i shtetit para vitit 1990; ç) të mos kenë qenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret. 3. Brenda dy viteve pas kalimit me sukses të procesit së rivlerësimit, subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, riemërohen si **magjistratë**. Ata kanë të drejtën për t’u caktuar në një pozicion për të cilin përmbushin kriteret, sipas nenit 47, të këtij ligji, si dhe të kandidojnë në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicione për magjistratë ose për pozicione të komanduara ose pozicione që mund të ushtrohen vetëm nga magjistratët.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se një ish gjyqtar që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe një ish gjyqtar dhe prokuror që nuk e ka përfunduar këtë shkollë, duke përfshirë një ish gjyqtar në Gjykatë Ndërkombëtare, Gjykatë të Lartë dhe Gjykatë Kushtetuese, kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e rivlerësimit dhe pas kalimit me sukses të kësaj procedure të riemërohen gjyqtar. Një ndër kriteret që është parashikuar për t’u riemëruar të ish gjyqtarëve dhe prokurorëve është të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

17.3. SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja vlerësojnë se neni 166 pika 1 e Ligjit Nr. 96/2016, konkretisht shprehja “**...të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës.... për 9 vjet, në 20 vitet e fundit**,” si dhe pika 2 gërma “b” e këtij neni, ku thuhet shprehimisht: **b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;..**”, janë në

kundërshtim me Kushtetutën, për këto arsye: **së pari**, në nenin 179/ b të Kushtetutës, të ndryshuar thuhet shprehimisht: “4... *Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish prokurorët, ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite nuk bëhet diferenca midis ish gjyqtarëve dhe ish prokurorëve që kanë përfunduar shkollën e magistraturës dhe që nuk kanë përfunduar këtë shkollë. Gjithashtu, në këtë dispozitë kërkohet që ish gjyqtari ose ish prokurori të ketë punuar të paktën tre vjet, për rrjedhojë kushti që magistrati që nuk ka përfunduar Shkollën e Magistraturës të ketë punuar si magistratë për 9 vjet, në 20 vitet e fundit, është në tejkalim të Kushtetutës, sikurse parashikimi që duhet të kenë përfunduar Shkollën e Magistraturës. **Së dyti**, kriteri që mos të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, bie në kundërshtim me nenet 136 pika 3, 136/a dhe 147 pika 4 të Kushtetutës, ku ky kriter kërkohet vetëm për kandidimin për anëtar në Gjykatën e Lartë dhe anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor që vijnë nga rradhët e jo gjyqtarëve dhe jo për gjyqtarët e shkallës së parë, ku konkurojnë persona që kanë përfunduar edhe Shkollën e Magistraturës. **Së treti**, neni 166 pika 2 gërma “b” e Ligjit Nr. 96/2016 cënon parimin e barazisë përpara ligjit parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës. Kjo për faktin pasi një ish gjyqtar apo ish prokuror që ka përfunduar Shkollën e Magistraturës duhet të plotësojë kriteret shtesë, të ndryshme nga ato që duhet të plotësojë një person që kandidon në Shkollën e Magistraturës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pra, nuk ka sens logjik dhe juridik që në nenin 28 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Kriteret e pranimit në formimin fillestar**” ku parashikohen kriteret për t’u bërë magistrat të mos jetë kriter mos mbajtja e pozicioneve politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit dhe në një dispozitë tjetër “Dispozita kalimtare” (neni 166) të parashikohen kriteret shtesë. Për më tepër që në nenin 53 pika 2 dhe 9 të këtij ligji parashikohet që magistrati mund të komandohet në çdo pozicion përfshi këtu pozicionin e këshilltarit të ministrit të Drejtësisë dhe drejtorit të kabinetit të ministrit dhe kjo konsiderohet përvojë profesionale si drejtues. Pra, nuk përjashtohet mundësia që magistrati të komandohet në pozicione pune që konsiderohen si pozicione politike në administratën publike. Këto dispozita kontradiktore bëjnë që të cënohet edhe parimi i sigurisë juridike.

C. Lidhur me cënimin e pranimit të sigurisë juridike.

18. Një nga elementët më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i **sigurisë juridike**, i cili, ndër të tjera ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qartë, të përcaktuar dhe të kuptueshëm.⁹ Sigurisht që ato nuk mund të parashikojnë çdo rast që mund dhe duhet të lindë nga njohja dhe zbatimi i tyre në praktikë. Prandaj, në radhë të parë është detyrë e gjykatave apo organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t'i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Por që të realizohet një gjë e tillë, para së gjithash ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt. Prandaj duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilëve u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilëve u drejtohet ligji në tërësi, ose dispozita të veçanta të tij.¹⁰

19. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se, parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara dhe e pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. **Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme**¹¹. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion **dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasojat pozitive**, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfutuese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave.¹² Pra, sipas parimit të sigurisë juridike,

⁹Shih Peter BADURA "Staatsrecht", Munchen 1996, fq.51D. Për lidhjen e parimit të shtetit të së drejtës me atë të sigurisë juridike, shih edhe Juha RAITO "Legal Certainty"-IVR Encyclopaedia of Jurisprudence, Legal Theory and Philosophy of Law", 5/2005

¹⁰Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese Gjermane 2BvR 2374/99, dt.18.05.2004 dhe BvR 581/01, dt.12.04.2005, etj.

¹¹Shiko vendimin Nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

¹²Shiko vendimin Nr. 29, datë 31.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre.

20. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se, **parimi i sigurisë juridike ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim kërkohet që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të.** Një rregullim i pasaktë i normës ligjore dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma.¹³

21. Përcaktimi i afateve kushtetuese e ligjore në ushtrimin e të drejtës së ankimit, përfshirë këtu edhe të drejtën e paraqitjes së kërkesës për rishikim, nuk përbën qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të rëndësishëm të sigurisë juridike, si një nga përbërësit themelorë të shtetit të së drejtës. Ky element theksohet edhe në një sërë vendimesh të mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtarë të krijuar për garantimin e të drejtave të njeriut.¹⁴

22. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar në fakt, ashtu si edhe në fushat e tjera të së drejtës, edhe në të drejtën penale parim i përgjithshëm është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Në rastin e ligjit penal, i cili si rregull kufizon lirinë individuale, është mëse e nevojshme që çdo qytetar, të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndjejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri penal që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar ose që mund të rëndojë pozitën e tij si i pandehur, do të ketë në të ardhmen fuqi prapavepruese.¹⁵

23. SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja, vlerësojnë të shprehen fillimisht nëse karriera e gjyqtarëve, përfshihet në rrethin e përfitimeve të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, neni 138 i Kushtetutës përcakton elementë përbërës të

¹³Shiko vendimet Nr. 9, datë 26.02.2007; Nr. 36, datë 15.10.2007; Nr. 52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese

¹⁴Shih vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.01.2000 në Ëaker kundër Mbretërisë së Bashkuar; vendimin e Komisionit të të Drejtave të Njeriut, datë 17.05.1984 në K.vs.Irlandës; vendimin Ndër-Amerikan të të Drejtave të Njeriut, datë 29.05.2003 në Mendoza vs Argjentinës, etj.

¹⁵Shiko vendimin Nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. **Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ.** Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre.¹⁶

24. Ligjvënësi i kishte përfshirë kriteret e rekrutimit dhe të karrierës së gjyqtarëve në ligjin organik për pushtetin gjyqësor (shih Kreun III të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar). Ky ligj parashikonte kushtet për t’u emëruar gjyqtar, procedurën dhe kriteret e emërimit të gjyqtarit në shkallët përkatëse si dhe mënyrën e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin e karrierës. Edhe Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit e përfshin karrierën në garancitë që gëzon gjyqtari së bashku me garanci të tjera si: paga, pensioni, përzgjedhja, rekrutimi dhe emërimi nga një entitet i pavarur. **Bazuar në analizën e mësipërme, Gjykata Kushtetuese në jurispradencën e saj ka vlerësuar se karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre. Mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë.**¹⁷ Pra, karriera në vetvete ka të bëjë me promovimin si në një gjykatë më të lartë në gjykatë Apeli apo në Gjykatë të Lartë, transferimi në një gjykatë tjetër karriere, emërimi kryetar gjykate, etj.

25. Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë, për shkak të funksionit. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. **Qëllimi i parimit të sigurisë**

¹⁶ Shiko vendimin Nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁷ Shiko vendimin Nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

juridike është të sigurojë besimin e personave te shteti e ligji dhe, vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë dhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës dhe garancisë.¹⁸

26. Në nenin 161 pika 3 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Dispozita kalimtare për magjistratët në Gjykatën e Lartë”** parashikohet shprehimisht se: **“3. Kryetari në detyrë vazhdon të ushtrojë detyrën si kryetar për një periudhë shtesë prej dy vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe të tjera ligjore për mbarimin e mandatit ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,** ndërsa në nenin 164 pika 2 të këtij ligji nën titullin **“Dispozitat kalimtare për magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera”** parashikohet shprehimisht se: **“2. Kryetarët e gjykatave dhe prokurorive vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë si kryetar deri 9 muaj pas ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”.** Ndërkohë në nenin 168 pika të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Dispozitat kalimtare për inspektorët me statusin e gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë”** parashikohet shprehimisht: **“2. Inspektori vazhdon të ushtrojë detyrën e tij, sipas mandatit të mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VII, të këtij ligji, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Inspektori në detyrë, sipas këtij neni, mandati i të cilit mbaron para krijimit të Këshillave, ka të drejtë të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të vazhdojë në detyrë edhe 6 muaj pas krijimit të Këshillave. Ai ka të drejtë të kandidojë në procedurën për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë në kuptim të këtij ligji.”.** Nga përmbajtja e këtyre dispozitave konkludohet se, **legjislatori për funksionarë të drejtësisë që kanë mandat kushtetues ose ligjor, ka parashikuar afate të ndryshme për mbarimin e mandatit,** konkretisht për Kryetarin e Gjykatës së Lartë është parashikuar se mund të vazhdojë detyrën edhe për dy vjet pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 96/2016, për kryetarët e tjerë të emëruar nga KLD-ja mund të qëndrojnë në detyrë deri në 9

¹⁸ Po aty.

muaj pas krijimit të KLGJ-së, ndërsa për inspektorët e KLD-së mund ta vazhdojnë detyrën sipas mandatit të mëparshëm.

Nisur nga ky formulim, me të drejtë lindin pyetjet:

- Kush ja ka deleguar këtë kompetencë ligjvënësit për t'i ndërprerë një mandat ligjor të fituar në përputhje me ligjin e kohës?
- A duhet ligjvënësi ta bazojë veprimtarinë e vetë në kuadër dhe zbatim të Kushtetutës dhe në respektim të parimit të shtetit të së drejtës dhe parimit të sigurisë juridike?

Përgjigjia është: Natyrisht që PO.

Prandaj, **vlerësojmë se Ligjvënësi me miratimin e këtyre kufizimeve ka dhunuar parimin e sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara.**

26.1. Në nenin 136 pika të Kushtetutës të pandryshuar parashikohet shprehimisht: “3. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi.”, ndërsa në nenin 179 pika 4 të Kushtetutës të ndryshuar, parashikohet se: “4. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.”. Pra, **duke qenë se një nga anëtarët zgjidhet kryetar i Gjykatës së Lartë ai vazhdon të ushtrojë detyrën për 9 vjet dhe sipas nenit 179 të Kushtetutës vetëm pasi i mbaron mandati mëparshëm, do të zbatohen dispozitat e reja kushtetuese për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, ku njëri prej tyre zgjidhet kryetar.** Ndodhur në këto kushte, vlerësojmë se neni 161 pika 3 i Ligjit Nr. 96/2016 jo vetëm që **cënon parimin e shtetit të së drejtës në mosrespektimin e hierarkisë së akteve normative,** parim i elaboruar nga jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese se **“atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji”**, por **cënon dhe parimin e sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara sikurse është dhe e drejta për të bërë karrierë parashikuar në konceptim e “të drejta të tjera” parashikuar nga neni 138 i Kushtetutës,** për ushtruar detyrën si kryetar i Gjykatës së Lartë sipas mandatit të fituar në kohën e emërimit, që natyrisht ka dhe një trajtim financiar më të lartë se sa i një anëtarit të Gjykatës së Lartë. Rrjedhimisht, bën që **të cënohet dhe e drejta e pagës,** që është diferenca midis pagës që do të merte nëse kryetari aktual i Gjykatës së Lartë do të qëndronte në detyrë deri më datë 22.03.2022, pasi Kryetari i Gjykatës së Lartë në detyrë është emëruar me dekretin Nr. 8065, të datës 22.03.2013 të Presidentit të Republikës.

26.2. Sa më sipër rezulton qartë se, Ligji Nr. 96/2016, **me fuqi prapavepruese,** synon të ndërpresë një madat kushtetues dhe ligjor të fituar në mënyrë të ligjshme. Sikurse e

theksua më lartë, **parimi i përgjithshëm është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit që nuk është favorizues për personin**. Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Gjyqtari apo kryetari i gjykatës nuk duhet të ndjejë për asnjë çast rrezikun, që një ligj i ri që mund të parashikojë ndërprerjen e mandatit si kryetar gjykate, do të ketë në të ardhmen fuqi prapaveprues. Për më tepër që në rastin konkret nuk jepet asnjë arsye objektive dhe e përligjur.

26.3. Gjithashtu, në nenin 17 të Ligjit Nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nën titullin “**Qëndrimi në detyrë, shkarkimi dhe mbarimi i mandatit të kryetarit të gjykatës**”, thuhet shprehimisht: *“1. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit qëndrojnë në detyrë për katër vjet, me të drejtë riemërimi, sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji. 2. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit shkarkohen kur nuk përmbushin detyrat e nenit 18 të këtij ligji. 3. Mandati i kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe i kryetarit të gjykatës së apelit mbaron para afatit: a) kur jep dorëheqjen; b) në rastet e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji; c) kur është në pamundësi fizike të ushtrimit të detyrës për më shumë se 3 muaj; ç) kur zgjidhet anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. 4. Shkarkimi i kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe i kryetarit të gjykatës së apelit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur kërkohet me shkrim nga jo më pak se 5 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ose nga Ministri i Drejtësisë. 5. Mbarimi i mandatit të kryetarit të gjykatës deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas kërkesës së motivuar të çdo anëtari të këtij Këshill.”*. Ndërsa në nenin 26 pika 3 të këtij ligji, nën titullin “**Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë**”, parashikohet shprehimisht: *“3. Paga bazë e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Mbi këtë pagë jepet një shtesë për drejtim në masën 10 për qind.”*.

26.4. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se mandati i kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe apelit është katër vjet dhe për shkak të drejtimi kanë një shtesë page me 10 përqind. Vlerësojmë se e drejta/garancia e kufizuar nga ndërhyrja e ligjvënësit në rastin konkret është karriera e cila, si pjesë integrale e statusit të gjyqtarit,

mbrohet nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha garancitë kushtetuese që përfshin ky nen **si palëvizshmëria, mbrojtja e pagës si dhe “përfitimet e tjera”** janë në funksion të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i tyre krijon njëkohësisht besimin te publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve.¹⁹ Gjithashtu, duke iu ndërprerë mandati si kryetar me fuqi prapavepruese, **kryetarit i cenohe dhe e drejta e pagës**, që përbëhet nga diferenca midis pagës pagës bazë plus 10 përqind shtesë për drejtim. Pra, në këtë rast **është cënuar dhe parimi i sigurisë juridike** në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të fituara dhe e pritshmërive të ligjshme. Po ashtu, në rastin konkret është **cenuar besueshmëria e gjyqtarëve/qytetarëve tek shteti** sa i përket pandryshueshmërisë së ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. **Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e gjyqtarit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme, sikurse është fitimi i një mandati si kryetar gjykate nëpërmjet ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e emërimit, konkretisht Ligjit Ligjit Nr.9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.** Pra, sipas parimit të sigurisë juridike, Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre.

27. Në nenin 103 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit**” parashikohet shprehimisht se: “*Sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si vijon: ...ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale ose **janë subjekte të një procedimi penal**, ose me persona të dënuar, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me magjistratin në lidhje gjaku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënieve të biznesit të **papërshtatshme** me këta persona; d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit; **dh) shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit**, në veçanti në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit, sipas ligjit; e) **sjellja e papërshtatshme** në përmbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksionarët e tyre, dhe raste të tjera me **sjellje***

¹⁹ Po aty.

të papërshtatshme të pajustificuar.”. Në këtë dispozitë parashikohen definicione “***sjellje e papërshtatshme***” dhe “***shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit***” janë koncepte që lënë hapësirë të gjerë interpretimi dhe shtojnë mundësinë e abuzivizmit. Një sjellje, që gjyqtarit si subjekt i këtij ligji i duket e përshtatshme, KLGJ-së dhe Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë mund t’i duket e papërshtatshme, përse kohë nuk ka një definicion të saktë të saj. Pra, **kësaj dispozite i mungon qartësia**. Shkeljet disiplinore dhe veprimet që përbëjnë shkelje disiplinore duhet të jenë të qarta, të kuptueshme, me qëllim që gjyqtari të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij si dhe sanksionet që mund t’i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Po ashtu, në vetvete “***shkelje e ligjit***”, përfshinë edhe një mospërmbushje detyrimi kontraktor si p.sh. mospagesa në kohë e energjisë elektrike apo e faturës së ujit, e cila shoqërohet me kamat, apo e çdo lloj detyrimit tjetër që rrjedhë nga marrëdhëniet kontraktore. Gjithashtu, “***shkelje të kryera të detyrimit të ligjit***”, përbën edhe një shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, e cila përbën kundërvajtje administrative dhe që dënohet me gjobë ose pezullim apo heqje të lejes së drejtimit? A ka qenë ky qëllimi legjislatorit? Në po, kjo do të sillte që **gjyqtari të dënohej dy herë për të njëjtën shkelje ligjore**, pasi në vetvete çdo shkelje e një detyrimi ligjor që parashikohet nga ligje të tjera të ndryshme nga Ligji Nr.96/2016 si rregull shoqërohet me një penaltitet. **Ligji në një shoqëri demokratike duhet të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të.** Një rregullim i pasaktë i normës ligjore dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma.

D. Lidhur me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

28. Në nenin 4 si dhe në preambulën e Kushtetutës deklarohet parimi i shtetit të së drejtës. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës, që lidhen me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues, janë parimi i ndarjes së pushteteve dhe i lidhur me këtë parim, ai i pavarësisë së gjyqësorit, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës dhe parimi i sigurisë juridike.²⁰ Pavarësia e gjyqësorit është një nga shtyllat qendrore të shtetit të së drejtës për shkak të pozicionit që zë dhe rolit që luan gjyqësori në një shoqëri demokratike.²¹

²⁰ Shiko vendimin Nr. 20, datë 11.07.2006 i Gjykatës Kushtetuese

²¹ Shiko vendimin Nr. 34, datë 20.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

29. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve deklarohet në nenin 7 të Kushtetutës, sipas të cilit “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”. Ky formulim do të thotë që ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Çdo institucion i secilit pushtet gëzon kompetencën sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket institucioni, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, nga raportet e tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. **Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese.**²² Pra, **parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve duhet të zbatohet jo vetëm në kuadër të veprimtarisë së mekanizmave apo institucioneve që veprojnë në një prej tre degëve kryesore të pushtetit shtetëror, por edhe në mekanizma të tjerë kushtetues që ushtrojnë funksionet e tyre kushtetuese sipas rastit, në mënyrë të pavarur apo si ndërthurje e kompetencave me institucioneve të tjera kushtetuese.**

30. Autonomia dhe pavarësia e gjyqtarëve përbëjnë garanci efektive për të drejtat e qytetarëve. Këto garanci gjejnë shprehjen e tyre në nenin 147/a të Kushtetutës, nga përmbajtja e së cilës “qeverisja” e gjyqësorit i është lënë në kompetencë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, ky organ kushtetues, i pavarur nga legjislativi dhe ekzekutivi, vendos, ndër të tjera, edhe për transferimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, për përgjegjësinë disiplinore të tyre si dhe i propozon Presidentit të Republikës për emërim, kandidaturat për gjyqtarë. Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Frymën e korporatës (vetëqeverisjes) në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kushtetutëbërësi e ka futur me qëllim të caktuar për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit. Pra, **i vetmi organ kushtetues që ka të drejtë të vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve është Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në të kundërt nëse do të parashikohej**

²²Shiko vendimin Nr. 11, datë 02.04.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

ndonjë organ tjetër shtetëror qoftë kjo edhe gjykatë do të cënohej parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

31. Në nenin 146 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Vendimet e këshillit për çështjet e disiplinës”** parashikohet shprehimisht: *“1. Këshilli merr çdo vendim në lidhje me: a) angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre; b) shtyrjet e seancave; c) pranueshmërinë e provave; ç) zgjidhjen e çështjes; d) çdo çështje tjetër që Këshilli e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes. 2. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli: a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore. 3. Këshilli nuk është i detyruar t’i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.”* Ndërsa në nenin 147 të këtij ligji nën titullin **“E drejta e ankimit për vendimet disiplinore”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka të drejtë të ankimojë çdo vendim të Këshillit për çështjet disiplinore në gjykatën kompetente.”*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se, KLGJ-ja pasi shqyrton kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë ILD) për procedimin disiplinor të gjyqtarit vendos ose rrëzimin ose pranimin e kërkesës, duke vendosur masën disiplinore. Nëse ILD nuk është dakord me vendimin e KLGJ-së ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë. Por, nga interpretimi logjik i dispozitave të mësipërme, ankimi do të bëhet vetëm kur rrëzohet kërkesa për procedim disiplinor ose vendoset një masë disiplinore më e lehtë nga ajo e prezantuar nga Inspektoriati, pasi nëse kërkesa për procedim disiplinor pranohet nuk ka sens logjik dhe juridik, për rrjedhojë nuk do të kishte se çfarë të gjykohej në gjykatë. Çështja që shtrohet në rastin konkret është nëse, *e drejta e ankimit që i është njohur ILD-së kundër vendimit të KLGJ-së që rrëzon kërkesën për vendosjen e masës disiplinore është në pajtim me ndarjen dhe balancimin e pushteteve? A ka kompetencë kushtetuese gjykata që të ndryshojë vendimin e KLGJ-së kur vendos rrëzimin e kërkesës për masë disiplinore dhe të vendosë një masë disiplinore tjetër ndaj një gjyqtari?*

Përgjigjia në rastin konkret është **JO**. Kjo për faktin pasi në nenin 147/a të Kushtetutës parashikohet se, i vetmi organ që ka të drejtë të vendosë një masë disiplinore ndaj gjyqtarit është KLGJ-ja.

31.1 Gjithashtu, për çështjen e ankimit ndaj masave disiplinore të KLGJ-së, Kushtetuta në nenin 140 pika 4 parashikon se: “4. *Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, **e drejta e ankimit ndaj vendimeve të KLGJ-së lejohet vetëm ndaj vendosjes së masës disiplinore dhe jo ndaj rrëzimit të saj.** Në këtë konkluzion arrihet nga interpretimi *a contrario* i kësaj dispozite kushtetuese. Ndodhur në këto kushte, nenin 147 pika 2 i Ligjit Nr. 96/2016 që parashikon ankimin e vendimeve të KLGJ-së në gjykatë nga ana e ILD-së, kundër rrëzimit të masës disiplinore jo vetëm që cënon parimin e ndarjes së pushteteve por, passjellë edhe një proces të parregullt gjyqësor, pasi gjykata që do ta shqyrtonte këtë kërkesë do të konsiderohej një gjykatë jo e caktuar me ligj. Kjo gjykatë, në kuptim të Kushtetutës nuk ka juridiksion për të vlerësuar meritat e zgjidhjes së çështjes disiplinore nga ana e KLGJ-së dhe të vendosë të ndryshojë vendimin nga “*rrëzim i kërkesës për caktimin e masës disiplinore në pranimin e kërkesës*” e për rrjedhojë të vendosë masë disiplinore. Gjykata ka kompetencë të vendosë vetëm të ndryshojë vendimin e KLGJ-së, duke rrëzuar kërkesën por jo anasjelltas. Kjo është dhe logjika juridike pse, që prej krijimit të KLD-së nuk është parashikuar e drejta e Ministrit të Drejtësisë që ka inicuar procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve, për të ankuar vendimet e KLD-së në gjykatë, në rastet e rrëzimit të kërkesave për procedim disiplinor.

E. Lidhur me respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

32. Standartet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur vendin e tyre në Kushtetutë si dhe një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, kanë përcaktuar dhe konsoliduar një sërë elementesh të procesit të rregullt ligjor, mungesa e të cilëve zhvlerësojnë si procedurat ashtu edhe vendimet e marra nga cilido organ. Argumentimi i shkeljeve që atribuohen, respektimi gjatë shqyrtimit i parimit të ndarjes së pushteteve, njohja paraprake e personit ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit me materialet, që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cënimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës.²³

33. Gjithashtu, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, në çdo rast KEDNJ vendos **standartet e domosdoshme dhe garancitë**, që çdo shtet kontraktues

²³Shiko vendimin Nr. 76, datë 25.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

duhet të sigurojë për të realizuar një proces të rregullt ligjor **dhe jo rrethin e personave që duhet të përfitojnë prej saj**. Ajo çmon se procesi i rregullt ligjor zbatohet për të gjitha konfliktet që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi qoftë ai edhe funksionar publik. Pra Gjykata Kushtetuese e shikon pozicionin e funksionarit publik në këndvështrimin e garancive që i siguron Kushtetuta, jurisprudenca e saj e deritanishme dhe fryma e KEDNJ. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka evidentuar dallimin që ekziston ndërmjet nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 42/1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal apo civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, **e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ, sic është rasti në shqyrtim.**²⁴ Më poshtë, SHKGJRSJ-ja dhe UGJSJ-ja do të evidentojnë elementët e një procesi të rregullt ligjor që çënohen nga Ligji Nr. 96/2016.

1. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e “krijuar me ligj”.

34. Gjykimi i çështjes nga një gjykatë “*e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ. Por, e drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon gjithashtu, që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë prej ligjit.²⁵ “*Një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar. Ai duhet gjithashtu të kënaqë një numër kërkesash të mëtejshme si pavarësia veçanërisht prej ekzekutivit; paanësia; qëndrueshmëria në detyrë e anëtarëve të tij; garancitë e ofruara nga procedura e tij – disa prej të cilave shfaqen edhe në vetë tekstin e nenit 6/1 të konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.²⁶

35. **Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit, për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit, brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e**

²⁴Shiko vendimin Nr. 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

²⁵Shiko vendimin Nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

²⁶ Vendimi “Belilos v. Zvicrës”, dt.29.04.1988

një çështjeje të caktuar. Problemet e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit, duke përfshirë edhe dispozitat për kompetencën, u takojnë në parim gjykatave të pushtetit gjyqësor. Megjithatë, duke u nisur edhe nga jurisprudenca kushtetuese, tejkalimet e kompetencave mund të merren në shqyrtim prej Gjykatës Kushtetuese, kur ka patur një shkelje të tillë të ligjit procedural, që ka cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është ndër të tjera parakusht për të mos lejuar, që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cenuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër (*ne bis in idem*), të parashikuar përkatësisht në nenet 4/1 dhe 34 të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar.²⁷

36. Duke u rikthyer në rastin konkret, për arsyet e përmendura në paragrafin 29 të kësaj kërkesë, vlerësojmë se neni 147 pika 2 i Ligjit Nr. 96/2016 që parashikon ankimin e vendimeve të KLGJ-së në gjykata nga ana e ILD, kundër rrëzimit të kërkesë për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit, cenon të drejtën për një proces të parregullt ligjor, pasi gjykata që do ta shqyrtonte këtë kërkesë do të konsiderohej një gjykata jo e caktuar me ligj, pasi në kuptim të Kushtetutës (ligji më i lartë në shtet) nuk ka juridiksion për të vlerësuar meritat e zgjidhjes së çështjes disiplinore nga ana e KLGJ-së dhe të vendosë të ndryshojë vendimin nga rrëzim i kërkesën për caktimin e masës disiplinore, në pranimin e kërkesës e për rrjedhojë të vendosë masë disiplinore ndaj gjyqtarit. **Gjykata ka kompetencë të vendosi vetëm të ndryshojë vendimin e KLGJ-së, duke rrëzuar kërkesën por jo anasjelltas.** Kjo është dhe logjika juridike pse, që prej krijimit të KLD-së nuk është parashikuar e drejta e Ministrit të Drejtësisë që ka inicuar procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve, për të ankuar vendimet e KLD-së në gjykatë, në rastet e rrëzimit të kërkesave për procedim disiplinor.

2. Lidhur me respektimin e të drejtës së mbrojtjes efektive dhe barazinë e armëve.

37. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë e respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykimin penal, duke ritheksuar se veçanërisht në procesin penal, këto parime dhe lidhur ngushtë me to, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përbëjnë në vetvete

²⁷ Shiko vendimin Nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

elementet më të qenësishëm e thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Këto standarde kushtetuese kërkojnë që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen ashtu si ato të prokurorit. Këto parime presupozojnë që, secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme, për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër. Synim kryesor i këtyre parimeve është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi.

38. Gjithashtu, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj, midis të tjerash, është shprehur se në kuptim të nenit 6, paragrafi 3, shkronja "d" të KEDNJ-së, çdo i akuzuar për kryerjen e veprës së dënueshme penale ka të drejtë "*të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës, si dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes në kushte të njëjta me ata të akuzës*". Megjithatë, nuk mjafton që i akuzuari të tregojë se i është mohuar mundësia t'u drejtojë pyetje disave prej dëshmitarëve, por duhet, përveç kësaj, të bëjë të besueshme se këto pyetje ishin të domosdoshme për të përcaktuar të vërtetën dhe se ky mosveprim i kishte cenuar të drejtën për t'u mbrojtur. Nëse gjykatat e zakonshme vërejnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë. Kjo nuk bëhet për të siguruar vetëm respektimin e barazisë së armëve, por dhe të parimit të kontradiktoritetit të gjykimit ose të shqyrtimit të provave.²⁸

39. Në nenin 100 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin "**Parimet e procedimit disiplinor**" parashikohet shprehimisht se: "*1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm; b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e "mosdënimit pa ligj"; c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore; ç) parimin e barazisë para ligjit; d) prezumimin e pafajësisë; dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor; e) parimin e proporcionalitetit; ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë*

²⁸shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Emmanuello kundër Italisë, datë 31.08.1999; Vidal kundër Belgjikës, datë 22.04.1992; Caka kundër Shqipërisë, datë 08.03. 2010.

së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit; f) parimin e drejtësisë së hapur; g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.”, ndërsa në nenin 141 të këtij ligji nën titullin **“Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor”** parashikohet shprehimisht se: **“1. Gjatë procedimit disiplinor, magjistratit ose përfaqësuesit të tij u sigurohet akses i plotë në dosje në masën që nuk cenon: a) interesat ligjorë të palëve ose personave të tretë; b) funksionet e organit vendimmarrës; c) qëllimin e procedimit.”**. Nga përmbajtja e këtyre dispozite pranohet se për procedimin disiplinor pranohen *mutatis mutandis* parimet e procesit penal. Gjithashtu, **nenin 141 pika 1 të këtij ligji nuk pranohet akses i plotë i gjyqtarit në dosjen që përmban aktete e procedimit disiplinor.** Gjykojmë se, kjo dispozitë që kufizon aksesin e gjyqtarit në dosjen e procedimit, bën që procesi disiplinor të jetë i parregullt, pasi çenohet e drejta për një mbrojtje efektive dhe barazia e armëve. Gjithashtu, duke qenë se në procedimin disiplinor zbatohen të njëjtat parime si në procesin penal dëshirojmë të theksojmë se, **të pandehurit në përfundim të hetimeve i garantohet akses i plotë mbi dosjen e prokurorisë, ndërsa në procedimin disiplinor gjyqtarit nuk i garantohet një e drejtë e tillë.** Po ashtu, vlerësojmë se arsyet që prezantohen për kufizimin e të drejtës së aksesit në dosje, nuk janë objektive dhe proporcionale, sikurse e kërkon neni 17 i Kushtetutës.

3. Lidhur me respektimin e parimit ne bis in idem.

40. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar, se parimi *ne bis in idem* është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga instrumentet kryesorë juridikë të brendshëm e ndërkombëtarë që rregullojnë marrëdhëniet në fushën penale si dhe përgjegjësinë për kundërvajtje. Sipas këtij parimi, askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar.²⁹ “*Ne bis in idem*” do të thotë literalisht “jo dy herë për të njëjtën” dhe nënkupton që asnjë veprim ligjor nuk mund të fillohet dy herë për të njëjtin shkak³⁰. Kriteri “e njëjta vepër” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar apo liruar. Nëse gjenden elementë të njëjtë, “ne bis in idem” ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm³¹. Nderkohë që një fakt i ri do të

²⁹ Shiko vendimin Nr. 10, datë 01.04.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁰ Vendimi nr.12, dt. 20.5.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

³¹ Shih Vendimi nr.5, dt. 08.03.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

gjykohet normalisht, edhe pse është kryer nga i njëjti person dhe ka të njëjtin cilësim ligjor me një fakt tjetër për të cilin ai është dënuar më parë. Gjykata Evropiane Për të Drejtat e Njëriut (G.J.E.D.Nj) ka mbajtur qëndrimin se “*ne bis in idem*” duhet të kuptohet si një ndalim për të gjykuar ose dënuar të njëjtin person për një vepër të dytë, për aq kohë sa akuza për këtë vepër bazohet në fakte identike ose fakte që janë të njëjta në substancë me ato të veprës së parë për të cilën ai është gjykuar ose dënuar.³² Gjykata, rast pas rasti, në zbatim të këtij parimi, duhet të fokusohet në ato fakte që përbëjnë një grup rrethanash faktike konkrete, që i takojnë të njëjtit të pandehur, dhe që janë të lidhura me njëra tjetrën në kohë dhe në hapësirë.

41. Përpara se të vijojmë me argumentimin e dispozitave që bien në kundërshtim të hapur me parimin kushtetues *ne bis in idem* dëshirojmë të theksojmë edhe një herë natyrën e procedimit disiplinor të gjyqtarëve. Në këtë drejtim mbajmë parasysh **Opinionin Nr. 789, datë 15 Dhjetor 2014 të Komisionit të Venecias** (Amicus Curia për Gjykatën Kushtetuese të Moldavisë”, ku ndër të tjera thuhet se: “**63. Nisur nga ngjashmëria midis procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe procedimit penal, parimi procedural penal i parashikueshmërisë së shkeljeve ligjore dhe të interpretimit të tyre të ngushtë (mos lejimi i interpretimit me analogji), zbatohet mutatis mutandis edhe në procedimin disiplinor.** Kështu, në opinionin e sipërpërmendur të OSCE/ODIHR JUD-MOL/217/2012 [LH] e datës 14 Dhjetor 2012, në paragrafin 10 të tij, përmendet qartësisht se një nga kërkesat themelore Evropiane dhe ndërkombëtare për ligjet kombëtare që rregullojnë procedimin disiplinor të gjyqtarëve, është: “**ekzistenca e një përcaktimi të saktë të veprimeve dhe mosveprimeve të cilat përbëjnë shkelje disiplinore**”, si dhe nenin 100 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Parimet e procedimit disiplinor**”, ku parashikohet shprehimisht “**1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: a) e drejta për një proces të rregullt,b) parimin e ligjshmërisë,....., si dhe parimin e “mosdënimit pa ligj”; ...d) prezumimin e pafajësisë; dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor; e) parimin e proporcionalitetit; ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit; f) parimin e drejtësisë së hapur; g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.”. Nga përmbajtja e opinionit të Komisionit të Venecias dhe nga vetë Ligji Nr. 96/2016 rezulton se për procedimin disiplinor të gjyqtarëve zbatohen *mutatis mutandis* parimet e procesit penal, ku përfshihet dhe**

³² Shih Vendimi Sergey Zolotukhin v. Russia, nr. 14939/03, dt.10.2.2009, parag. 82.

parimi *ne bis in idem*. Ndodhur në këto kushte, më poshtë do të trajtojmë se disa nga dispozitat e Ligjit Nr. 96/2016 çenojnë parimin kushtetues *ne bis in idem*.

41.1. Kështu, në nenin 23 pika 10 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Pushimet vjetore**” parashikohet shprehimisht se: “10. Me përjashtim të rasteve të sëmundjes ose aksidentit, magjistrati nuk mund të kryejë mungesa në detyrë. Nëse magjistrati ka kryer mungesa në detyrë, të cilat nuk janë miratuar, ato zbriten nga periudha e pushimeve vjetore. Pavarësisht nëse jepet masë disiplinore ose jo, magjistrati nuk paguhet për ditët e munguara.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se nëse magjistrati kryen mungesa në detyrë ka këto penalitete: a) nuk paguhet për ditët e munguara; b) edhe pse nuk paguhet për ditët e munguara i zbriten nga periudha e pushimeve vjetore për aq ditë sa ka mungur; dhe c) mban dhe përgjegjësi disiplinore për mungesat në detyrë që nuk i janë miratuar. Vlerësojmë se kjo dispozitë që parashikon disa penalitete në të njëjtën kohë, për të njëjtin veprim jo vetëm që është disproporcionale dhe nuk respekton parimin e proporcionalitetit parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës dhe neni 100 pika 1 gërma “e” të Ligjit Nr. 96/2016 por çënon në mënyrë të hapur dhe parimin kushtetues *ne bis in idem* pasi askush nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtën shkelje, pra edhe mos të paguhet, edhe t’i zbiriten ditët e mungura nga pushimet vjetore edhe të përgjigjet disiplinarisht.

41.2. Gjithashtu, në nenin 104 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale**” parashikohet shprehimisht: “Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë: a) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë; b) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale nga pakujdesia; c) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat “a dhe “b”, të këtij neni, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë; ç) faktet e pranuar nga organi kompetent me vendim të formës së prerë, që për nga vetë natyra e tyre është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut te magjistrati dhe organet e drejtësisë, të cilat përbëjnë veprë penale, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, është rehabilituar apo ka përfituar nga falja dhe amnistia.”. Nga

përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se Ligjvënësi parashikon si shkaqe të përgjegjësive disiplinore deklarimin fajtor të një gjyqtari për një vepër penale kundravajtje të kryer nga pakujdesia apo me dashje, apo edhe nëse nuk është deklaruar fajtor për shkak se vepra penale është shuar, amnistuar. Vlerësojmë se kjo dispozitë bie në kundërshtim të hapur me nenin 140 pika 2 gërma “b” të Kushtetutës,³³ duke cenuar dhe parimin kushtetues që askush nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtin fakt, duke duke pasur parasysh dhe faktin që për procedimin disiplinor zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e procedimit penal. Nga përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese rezulton se Kushtetuta, pa lënë shteg për mëdyshje, ka parashikuar në mënyrë shteruese si rastet e shkarkimit ashtu dhe rastet e pezullimit të gjyqtarit nga detyra, si garanci për ushtrimin normal të detyrës. Gjithashtu, Kushtetuta i ka diferencuar si shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës që lidhen me shkeljet disiplinore që lidhen me shkeljet e rënda profesionale dhe etike gjatë ushtrimit të detyrës nga ato sjellje që në vetvete përbëjnë veprë penale, duke i parashikuar si shkaqe të ndryshme për largimin nga detyra. Kjo jo pa qëllim, pasi nëse gjyqtari do të dënohej dy herë për të njëjtin fakt, sjellje, veprim ose mosveprim, si nga gjykata penale ashtu dhe nga KLGJ-ja, (për një nga shkeljet disiplinore të ndryshme nga shkarkimi, të cilin vetë kushtetuta e parashikon si një shkak të posaçëm të largimit nga detyra), atëherë do të shkelej parimi i dënimit dy herë për të njëjtin fakt. Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se rasti i posaçëm i shkarkimit parashikuar nga Kushtetuta kur gjyqtari dënohet me një vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi, është i një natyre konstatuese dhe jo vlerësuese nga ana e KLGJ-së dhe nuk hynë në shkaqet shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, të cilat vetë Kushtetuta i ka diferencuar si shkaqe dhe që është veprimtari e mirëfilltë e procedimit disiplinor të KLGJ-së, ku ndiqen të gjitha hallkat e procedimit disiplinor. Prandaj, nëse përpara KLGJ-së prezantohet një vendim gjyqësor penal i ndryshëm nga ai që ka parashikuar Kushtetuta sikurse është vendimi penal i formës së prerë për kryerjen e një krimi, dhe vendimet e tjera penale nuk lidhen me shkaqet si: shkelje të

³³ Në nenin 140 të Kushtetutës të ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. 3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit. 4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.”.

rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, atëherë KLGJ-ja nuk mund të fillojë procedim disiplinor për rastet e parashikuara nga neni 104 i Ligjit Nr. 96/2016, pasi në të kundërt do të gjykonte dhe do të dënonte dy herë gjyqtarin për të njëjtën shkelje, duke pasur parasysh faktin se për procedimin disiplinor zbatohen mutatis mutatis të njëjtat parime si në procesin penal, pra barazohet me procesin penal, ku nuk lejohet të dënohesh dy herë për të njëjtin veprim, sjellje apo fakt.

41.3. Në nenin 112 pika 1 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Masa disiplinore plotësuese”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Nëse magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e korrupsionit, **Këshilli vendos përveç shkarkimit të magjistratit edhe kthimit të shumës së pagës bruto të vitit të fundit në detyrë të përfutur prej tij.**”*. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se pasi gjykata penale ka dënuar magjistratin me vendim të formës së prerë, për veprën penale të korrupsionit, KLGJ-ja krahas masës së shkarkimit nga detyra, ka të drejtë që të vendosë që gjyqtari të kthejë shumën e pagës bruto të vitit të fundit në detyrë të përfunduar prej tij. Konstatojmë se kjo dispozitë cënon parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt. Gjithashtu, në kuadrin e një procesi penal është vetëm gjykata ajo që ka të drejtë të vendosë dënime plotësuese ndaj një të pandehuri, përfshi këtu edhe magjistratët. Kështu, në nenin 36 të Kodit Penal nën titullin **“Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale”** parashikohet shprehimisht: *“1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit: a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale; b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale; c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale; ç) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale; d) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë vepër penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi. 2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit. 3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale. 4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse*

produktet e veprës penale.”. Nëse gjykata do të aplikonte këtë dënim plotësues dhe po KLGJ-ja do të aplikonte dënimin plotësues në procedimin disiplinor që zbatohen të njëjtat parime si të procesit penal, atëherë kjo do të cënonte parimi *ne bis idem*. Gjithashtu, do të cenohet ky parim edhe nëse gjykata nuk do të aplikonte këtë dënim plotësues pasi vendimi i formës së prerë i gjykatës nuk mund të vihet në diskutim nga KLGJ-ja ashtu sikurse dhe çdo institucion tjetër shtetëror. Po ashtu, vlerësojmë se kthimi i pagës bruto të paguar magjistratit vitin e fundit të detyrës, në vetvete nuk është gjë tjetër veçse dënim me gjobë. Duke qenë se në procesin penal dënimet me gjobë është një nga dënimet kryesore atëherë ndaj tij nuk mund të caktohen dy dënime kryesore, me burgim dhe me gjobë. Në këtë përfundim arrijmë duke pasur parasysh faktin se procedimi disiplinor në vetvete nuk është gjë tjetër veçse një procedim penal. Dhënia e dy dënimeve kryesore ndaj një personi është antikushtetues në kuptim të vendimit Nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese. Dëshirojmë të theksojmë, gjithashtu, se dënimet me burgim, shkarkimi nga detyra dhe dënimet me gjobë nga KLGJ-ja për kthimin e pagës së dhënë magjistratit vitin e fundit të detyrës, përbën një masë disproporcionale që nuk përputhet me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës. Vlejnë të njëjtat argumenta që ka përdorur Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 47, datë 26.07.2012.

4. Lidhur me respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

42. Kushtetuta parashikon se kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë (neni 30 i Kushtetutës). Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza.³⁴

42.1. Në nenin 169 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve”** parashikohet shprehimisht se: **“5. Pjesa II, kreu III,**

³⁴ Shiko vendimin Nr. 4, datë 23.02.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1 janar 2019. Përfundimisht nga ky rregull bëjnë magistratët në institucionet për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, të cilët përfitojnë pagat dhe përfitimet e tjera, sipas këtij ligji, me caktimin në mënyrë të përhershme në këtë pozicion. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për magistratin, i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitime të tjera. 6. Magjistrati që ka kaluar procesin e rivlerësimit pas datës 1 janar 2019 gëzon të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera, sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe pagës dhe përfitimeve të tjera, sipas parashi-kimeve të këtij ligji, brenda tre muajve nga vendimi i formës së prerë të rivlerësimit.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se pjesa e dispozitave që flasin për pagën dhe përfitimet e tjera që duhet theksuar se është mirëpritur nga të gjithë gjyqtarët, si një nga gjërat pozitive në kuadrin e reformës në Drejtësi nuk do të aplikohet për ata gjyqtarë që nuk kanë kaluar ende procesin e ashtëquajtur vetting ose rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe jo më shpejtë së data 1 janar 2019. Por çfarë është në vetvete vettingu? Nuk është gjë tjetër veçse një proces disiplinor i gjyqtarëve dhe prokurorëve, por që nuk kryhet nga organet natyrore të procedimit të gjyqtarëve sikurse është KLGJ-ja por nga organe të tjera të përkohshme (në vetvete gjykata të jashtëzakoshme) sikurse janë Kolegji i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Apelimit. Po procedimi disiplinor i gjyqtarëve çfarë është në vetvete? Sikurse e kemi theksuar më lartë në paragrafin 39 të kësaj kërkesë 2016 rezulton se për procedimin disiplinor të gjyqtarëve zbatohen *mutatis mutandis* parimet e procesit penal, ku përfshihet dhe parimi i *prezumimit të pafajësisë*. Kjo parashikohet në **Opinionin Nr. 789, datë 15 Dhjetor 2014 të Komisionit të Venecias** (Amicus Curia për Gjykatën Kushtetuese të Moldavisë”, si dhe në nenin 100 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Parimet e procedimit disiplinor”**, ku parashikohet shprehimisht *“I. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: ...d) **prezumimin e pafajësisë..”**. Ndodhur në këto kushte, konstatojmë se neni 169 pika 5 i Ligjit Nr. 96/2016 cënon në mënyrë të hapur parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi i prezumon fajtor të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Republikës së Shqipërisë, përfshi këtu edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, duke u*

prezumuar si të paaftë profesionalisht, sikur nuk justifikojnë pasurinë e tyre dhe sikur kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. **Kjo dispozitë jo vetëm që cënon parimin e prezumimit të pafajësisë duke e filluar procesin e vettingut me paragjykim se të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët janë fajtor, por në vetvete kjo dispozitë cënon në thelb nderin dhe dinjitetin e gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë qoftë si funksionar publik, qoftë dhe si individ.**

Ë. Lidhur me respektimin e parimit të barazisë përpara ligjit.

43. Sipas nenit 18 të Kushtetutës, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë, mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Konkretisht, ajo është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”.³⁵

44. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se organi ligjvënës është i detyruar t’i përmbahet këtij parimi kur bëhet fjalë për “barazinë në ligj”. Në lidhje me mosdiskriminimin, ajo ka përcaktuar disa standarde, me anë të të cilave ka synuar të vlerësojë nëse një ligj është diskriminues në termat e nenit 18 të Kushtetutës. Kështu, Gjykata shqyrton nëse ligji ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se po, a ka qenë diferencimi i përlligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përlligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përlligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e

³⁵ Shiko vendimin Nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese.

diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, shqyrton nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme.³⁶

45. Gjykata Kushtetuese, gjithashtu, në jurisprudencën e saj ka theksuar se Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi **e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës**, pra respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimin në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, **ose me çdo shkak tjetër**. Po sipas këtij ligji, parimi i barazisë nënkupton: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, (*neni 1 dhe 2 i Ligjit*).³⁷

46. Nën dritën e këtyre konsideratave të përgjithshme mbi parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, mendojmë se neni 169 pika 5 i Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve”** ku parashikohet shprehimisht se: **“5. Pjesa II, kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1 janar 2019.”**, në vetvete çënon parimin e barazisë përpara ligjit. Kjo për faktin pasi do të ndodhë dhe mund të ndodhë që në të njëjtën kohë, në një gjykatë, madje në një trup gjykues, dy gjyqtar për punën e tyre të përditshme, të kenë një trajtim financiar të ndryshëm (rroga e gjyqtarit rritet me 100%), kjo vetëm për faktin se një gjyqtar e kalon procesin e rivlerësimit më datë 1 janar 2019 apo më përpara dhe një gjyqtar tjetër në të njëjtën gjykatë e kalon pas pesë vitesh apo edhe më tepër. A ka sens logjik dhe juridik që gjyqtarë të së njëjtës shkallë të kenë trajtim financiar krejtësisht të ndryshëm? Natyrisht që jo. Duke qenë se një gjyqtar jep të njëjtin shërbim ashtu si çdo gjyqtar tjetër, në të njëjtën shkallë gjykimi apo në të njëjtën gjykatë, duhet të trajtohet njëllë në të gjitha të drejtat dhe garancitë ligjore dhe kushtetuese. Paga është e drejtë e gjyqtarit dhe detyrim i

³⁶ Shiko vendimin Nr. 48 datë 15.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese

³⁷ Po aty

shtetit për shërbimin e dhënies së drejtësisë nga çdo gjyqtar i Republikës së Shqipërisë, për rrjedhojë nuk mund të kushtëzohet nga asnjë kusht tjetër. Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë edhe një herë se kjo dispozitë çënon në vetvete nderin dhe dinjitetin e gjyqtarëve.

F. Lidhur me respektimin e së drejtës për punë.

47. E drejta për punë, sipas nenit 49/1 të Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkupton çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale, përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që i jep Kushtetuta individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit, ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjeshtë një e drejtë për të patur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit, gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që i bën neni 49 i Kushtetutës të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë.³⁸ Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.³⁹

48. Duke u rikthyer në rastin konkret, vlerësojmë se Ligji Nr. 96/2016 çënon nenin 49 të Kushtetutës. Kjo për këto arsye: **së pari**, neni 8 i Ligjit Nr. 96/2016 çënon të drejtën e vendit të punës duke e transferuar gjyqtarin në një gjykatë (vend) tjetër pa pëlqimin e tij duke i ndryshuar vendin e punës. **Së dyti**, neni 26 pika 4 gërma “b” i Ligjit Nr. 96/2016 që parashikon se KLGJ-ja mund të ulë pagën e gjyqtarit për arsye të uljes së ngarkesës për

³⁸Shiko nenin 15 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “2. *Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.*”

³⁹ Vendimi Nr. 20, datë 11 Korrik 2006 i Gjykatës Kushtetuese.

shkaqe të pavarura nga vullneti i gjyqtarit (arsye shëndetësore) cënon të ardhurat e ligjshme të gjyqtarit, si e vetmja mundësi për të siguruar jetesën e tij. **Së treti**, neni 161 pika 3 dhe 164 pika 2 të Ligjit Nr. 96/2016 që ndërpretë me fuqi prapavepruese mandatin e kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit, jo vetëm që cënon të drejtën e karrierës së tyre, por cënon dhe të drejtën e pagës, pasi me fuqi prapavepruesi kryetarëve të gjykatave që marrim një shtesë mbi pagë për drejtim 10%, nuk mund ta përfitojnë deri në përfundim të mandatit të tyre, të fituar në mënyrë të ligjshme. Pra, edhe këto dispozita cënojnë të drejtën për të përfituar të ardhurat e ligjshme në përputhje me vendin e punës (kryetar gjykate). **Së katërti**, neni 169 pika 5 i Ligjit Nr. 96/2016 i cili cënon parimin e barazisë përpara ligjit, duke sjellë që në të njëjtën kohë dy gjyqtarë të së njëjtës shkallë të kenë trajtim financiar të ndryshëm, situatë që mund të zgjasi për më tepër se pesë vjet, cënon edhe nenin 49 të Kushtetutës, pasi gjyqtari nuk paguhet në përputhje me vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme.

G. Lidhur me respektimin e parimit të proporcionalitetit.

49. Në nenin 17 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se: *“1. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. 2. Këto kufizime nuk mund të cënojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mund të bëhet vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: *i)* Kufizimi duhet të vendoset me ligj. Shprehja *“vetëm me ligj”* ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecionin vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Përdorimi i kësaj shprehje nuk është i rastit, por është bërë për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit.⁴⁰; *ii)* Kufizimi duhet të bëhet për një interes publik. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykatës Kushtetuese, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që mund të justifikojnë ndërhyrjen në një të

⁴⁰ Shiko vendimin Nr. 20, datë 11.7.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

drejtë/garanci kushtetuese. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë.⁴¹ *iii*) Një kusht tjetër që duhet të respektojë ligjvënësi në vendosjen e kufizimit është që ky kufizim të jetë në *përpjesëtim* me gjendjen që e ka *diktuar* atë. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Përveç kësaj, kushti i proporcionalitetit të *ndërhyrjes* me gjendjen që e ka *diktuar* atë (ndërhyrjen), imponon ligjvënësin të aplikojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë gjithashtu edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i *përpjesëtimit* të kufizimit me gjendjen që e ka *diktuar*, konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar *interesin publik* që *dikton* kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit.⁴² *iv*) Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

50. Në nenin 105 pika 1 gërma “d” të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Masat disiplinore**” parashikohet shprehimisht: “1. Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore: ...d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitim të pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.”, ndërsa në nenin 110 të këtij ligji nën titullin “**Pezullimi si masë disiplinore**” parashikohet shprehimisht se: “Masa e pezullimit nga detyra e magjistratit, me të drejtën për të marrë pagën minimale për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, jepet vetëm në këto raste: a) kur shkelja është e shumë e rëndë; b) kur Këshilli çmon se, pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar.”. Nga përmbajtja e këtyre

⁴¹ Shiko vendimin Nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

⁴² Shiko vendimin Nr. 16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

dispozitave rezulton se gjyqtari mund të pezullohet deri në dy vjet nga detyra, ndërkohë që i jepete një pagë minimale. Vlerësojmë se pezullimi në vetvete në të gjitha ligjet procedurale nuk mund të jetë masë disiplinore në vetvete por si një masë e përkohshme deri në zgjidhjen e një situate ligjore. Gjithashtu, vlerësojmë se kjo masë disiplinore nuk është proporcionale dhe efektive, pasi lënia e gjyqtarit pa punë për një periudhë dy vjeçare nuk mund të përputhet me interesin publik, sepse përsa kohë që nga shkelja që ka kryer gjyqtari nuk ka cënuar imazhin në publik atëherë do të thotë që gjyqtari mund të japë drejtësi pa cënuar besimin e publikut. Po ashtu, mjeti nuk është efektiv pasi përsa kohë që gjyqtari nuk është i papërshtatshëm dhe i padenjë për të dhënë drejtësi atëherë qytetarët privohen nga dhënia e shërbimit të drejtësisë dhe njëkohësisht cënohet si buxheti i shtetit duke paguar një gjyqtar pa dhënë shërbimin e drejtësisë dhe nga ana tjetër gjyqtari i mohohet e drejta për të ushtruar detyrën e të paguhet me pagën normale si i vetmi burim jetese. Pra, kjo dispozitë në këndvështrimin tonë nuk e kalon testin e proporcionalitetit.

51. Në nenin 117 të Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin “**Afatet e parashkrimit**” parashikohet shprehimisht se: “**1. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë, sipas nenit 119, të këtij ligji, paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna, sipas nenit 124, të këtij ligji, pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar, ai nuk fillon hetimin për shkak të parashkrimit. 2. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer. 3. Nëse magjistrati kryen shkelje tjetër të së njëjtës natyrë brenda afatit të parashkrimit, afati zgjatet deri në një vit. 4. Pavarësisht parashikimeve të pikave 1 dhe 3, të këtij neni, për shkeljet disiplinore që përbëjnë njëkohësisht vepra penale, afatet e parashkrimit përllogariten sipas parashikimeve të Kodit Penal, vetëm nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet.**”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite konstatohet se afati i parashkrimit për çdo shkelje disiplinore, pa i kategorizuar ato është pesë vjet. Gjithashtu, në këtë dispozitë parashikohet një rregull i ri që zgjatë afatit e parashkrimit me një vit kur gjyqtari kryen të njëjtën shkelje brenda afatit të parashkrimit, dhe nëse shkelja disiplinore përbën edhe vepër penale, afatet e parashkrimit përllogariten sipas parashikimeve të Kodit Penal vetëm nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet. Vlerësojmë se kjo dispozitë cenon në mënyrë të hapur parimin e proporcionalitetit. Nuk ka sens logjik dhe juridik që një shkelje disiplinore e cila në vetvete nuk përbën vepër penale, të parashikojë afate parashkrimi më të gjata se një vepër penale, që përbën një veprim me

rrezikshmëri më të lartë. Një parashikim i tillë nuk i shërben interesit publik, e cili si rregull është më i lartë në rastin e veprave penale se në rastin e shkeljeve disiplinore. Kështu, në nenin 66 të Kodit Penal nën titullin **“Parashkrimi i ndjekjes penale”** parashikohet shprehimisht se: *“Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë; b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.”*. Pra, nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se në ligjin penal bëhet një kategorizim i afateve në varësi të rëndësisë së shkeljes penale. Pra, qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e afateve të parashkrimit është: *së pari*, realizimi në praktikë i efektit të përgjithshëm dhe të veçantë parandalues të dënimit në çdo rast konkret dhe *së dyti*, disiplinimi i procesit disiplinor duke vendosur detyrimin e inspektoriatit që të evidentojë shkeljet në një kohë sa më të shpejtë dhe të inkurajojë subjektet që kanë të drejtën e ankimit ndaj shkeljeve disiplinore t'i denoncojnë ato sa më shpejtë. Ndodhur në këto kushte, vlerësojmë se në këtë rast afatet e parashkrimit të procesit disiplinor të gjyqtarëve nuk e kalon testin e proporcionalitetit, pasi afati 5 vjeçar i parashkrimit nuk i përgjigjet të gjitha shkeljeve disiplinore. Gjithashtu, ky afat duhet ulur dhe kurrsesi nuk mund të jetë asnjëherë i barabartë apo më i lartë se afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

52. Në nenin 169 pika 5 i Ligjit Nr. 96/2016 nën titullin **“Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve”** parashikohet shprehimisht se: **“5. Pjesa II, kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht kësaj, në asnjë rast jo më shpejt se 1 janar 2019.”**. Vlerësojmë se kufizimi i përfitimit të pagës dhe dhe përfitimeve të tjera që parashikohen në këtë ligj me kalimin e procesit të vettingut, jo vetëm që çënon parimin e prezumimit të pafajësisë e barazisë përpara ligjit, por çënon në mënyrë të hapur dhe parimin e proporcionalitetit. Kështu, në rastin konkret nuk justifikohet interesi publik i këtij kufizimi. **Madje i pajustificuar është dhe afati 1 Janar 2019 i vendosur për marrjen e pagës së re.** Në këtë përfundim arrijmë duke iu referuar relacionit që shoqëroi Ligjin Nr. 96/2016 në Kuvend. Kështu, në relacionin e këtij ligji thuhet shprehimisht: *“Projektligji për Statusin parashikon gjithashtu përmirësim rrënjësor të*

trajtimit financiar dhe të masave mbështetëse gjatë dhe pas lënies së detyrës, duke u mbështetur në parimin se niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që ti mbrojnë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. 3 Duke u mbështetur në Kartën Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve, ligji parashikon që magjistratët të përfitojnë nga sigurimet shoqërore, me fjalë të tjera mbrojtje kundër rreziqeve të zakonshme sociale, të tilla si sëmundje, barrë lindje, invaliditet, pleqëri dhe vdekje. Gjithashtu, Projektligji reflekton standartet e Kartës Evropiane, sipas së cilës, niveli i shpërblimit të një gjyqtari në krahasim me një tjetër mund të jetë subjekt i faktorëve të tillë si kohëzgjatja e shërbimit, natyra dhe rëndësia e detyrave, vështirësia e tyre, etj.". Pra, nga përmbajtja e këtij relacioni rezulton se qëllimi pse u parashikua rritja e pagës dhe përfitimeve të tjera lidhet me parimin se niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që ti mbrojnë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Pyetja që shtrohet natyrshëm është a ka ndryshuar qëllimi i legjislatorit nëpërmjet miratimit të Ligjit Nr. 96/2016 duke e zgjatur afatin e fillimit të përfitimit në vitin 2019 dhe duke e kushtëzuar me kalimin e procesit të vettingut që mund të zgjasë edhe mbi pesë vjet ligjërishit? A nuk duhet që nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 96/2016 niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që ti mbrojnë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit apo deri në vitin 2025 Legjislatori nuk e ka më shqetësim presionin financiar që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarit? SH.K.GJ.R.SH dhe UGJSH vlerësojnë se qëllimi i Legjislatorit i pasqyruar në relacionin që shoqëroi Ligjin Nr. 96/2016 është i drejtë dhe i shërben interesit publik, por mjeti që zgjodhi Legjislatori me parashikimin e nenin 169 pika 5 është i gabuar dhe nuk justifikohet me interesin publik. **Prandaj, kjo dispozitë duhet të shpallet antikushtetuese tërësisht përfshi këtu dhe fillimin e efekteve të rritjes së pagës më datë 1 janar 2019, pasi interesi publik ka ekzistuar dhe ekziston se niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që ti mbrojnë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.** Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është e sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete, por ajo lidhet me mirëfunksionimin e shtetit dhe të drejtën e shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës. Pra, është në interesin dhe të shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe ti mbrojnë gjyqtarët nga presionet financiare që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

III. KONKLUZIONI

53. Sa më sipër u arsyetua, SH.K.GJ.R.SH-ja dhe UGJH-ja kërkojnë:

1. Deklarimin dhe shfuqizimin e neneve 8, 23 pika 10, 26 pika 4 gërma “b”, 28 gërma “c”, 53 pika 3 dhe 10, 104 pika “ç”, 105 pika 1 gërma “d”, 110, 112 pika 1, 117, 119 pika 2 gërma “a”, 141 pika 1, 147 pika 2, 150, 152, 160, 161 pika 3, 162 pika 2 gërma “b”, 164 pika 2, 165, 166 pika 1 dh 2 gërma “b”, 169 pika 3, 5 dhe 6, dhe neni 173 pika 1, të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si të papajtueshëm me Kushtetutën.

2. Pezullimi i zbatimit të Ligjit Nr. 96/2016, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

KRYETARI I SH.K.GJ.R.SH

ERJON BANI

KRYETARI I UNIONIT

GERD HOXHA